

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2024

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundi mit të kërkesës	Tarifa
1.	05.01.2024	<p>Kërkesë për t'u pajisur me informacion: Sa është vlera totale për ndihmë sociale që është dhënë për gratë/femrat e dhunuara?(Te ndara sipas viteve 2020-2021-2022-2023); Sa është buxheti i bashkisë tuaj për dhunën në familje? (Te ndara sipas viteve 2020-2021-2022-2023)?; Sa gra/femra të dhunuara kanë përfituar subvencionim të qirase/ bonus qiraje nga bashkia juaj? (Te ndara sipas viteve 2020-2021-2022-2023); Sa gra/femra të dhunuara kanë përfituar kredi të buta për vitet 2020-2021-2022-2023? (sa kanë aplikuar dhe sa e kanë përfituar) ?</p> <p>Cila është problematika me e madhe që keni ndeshur për të ndihmuar/mbeshtetur , gratë / femrat e dhunuara përgjatë këtyre viteve (2020-2023)?</p>	15.01.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 05.01.2024, po ju vendosim në dispozicion bashkangjitur të dhënat e marra nga Drejtoria e Kujdesit Social, Bashkia Korçë:</p> <p>1.Sa është vlera totale për ndihmë sociale që është dhënë për gratë/femrat e dhunuara?</p> <p>-Gjatë vitit 2020 janë pajisur me UM 30 raste të cilët kanë përfituar ndihmë sociale si viktimë e dhunës në familje.</p> <p>-Gjatë vitit 2021 janë pajisur me UM 29 raste të cilët kanë përfituar ndihmë sociale si viktimë e dhunës në familje.</p> <p>-Gjatë vitit 2022 janë pajisur me UM 28 raste të cilët kanë përfituar ndihmë sociale si viktimë e dhunës në familje.</p> <p>-Gjatë vitit 2023 janë pajisur me UM 36 raste të cilët kanë përfituar ndihmë sociale si viktimë e dhunës në familje.</p>	E plotë	S'ka tarifë

				<p>2.Sa është buxheti i bashkisë tuaj për dhunën në familje? 2020-Total=424,900 2021-Total=424,900 2022-Total=388,900 2023-Total= 520,000</p> <p>3.Sa gra/femra të dhunuara kanë përfituar subvencionim të qirasë/ bonus qiraje nga bashkia juaj? 2020-Nuk ka pasur kërkesa nga kjo kategori. 2021-Nuk ka pasur kërkesa nga kjo kategori. 2022-Në kuadër të bashkëpunimit me OJF 4 (katër) familje kanë përfituar subvencionim të qirasë/bonus qiraje. 2023-Në kuadër të bashkëpunimit me OJF 1 (një) familje ka përfituar subvencionim të qirasë/ bonus qiraje.</p> <p>4.Sa gra/femra të dhunuara kanë përfituar kredi të buta (sa kanë aplikuar dhe sa e kanë përfituar) ? 2020-Nuk ka pasur kërkesa nga kjo kategori. 2021-Nuk ka pasur kërkesa nga</p>		
--	--	--	--	--	--	--

			<p>kjo kategori.</p> <p>2022-4 (katër) familje të kësaj kategorie kanë qënë aplikues dhe përfitues të kredive të buta në Bashkinë Korçë.</p> <p>2023-1(një) familje e kësaj kategorie ka qënë aplikuese dhe përfituese e kredive të buta në Bashkinë Korçë.</p> <p>5.Cila është problematika më e madhe që keni ndeshur për të ndihmuar/mbështetur , gratë / femrat e dhunuara përgjatë këtyre viteve? Problematikat dhe sfidat që hasen gjatë menaxhimit të një rasti janë nga më të ndryshmet, në varësi të situatës së rastit. Ato që mund të përmenden janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Historiku i gjatë i dhunës në familje dhe rastet e përsëritura. - Trajtimi i rasteve të dhunës që kanë problematika të shëndetit mendor është gjithashtu një sfidë si dhe mungesa e një qendre për personat me probleme të shëndetit mendor. - Tërheqja e personit të dhunuar për t’u pajisur me Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje apo Urdhër Mbrojtje nga Gjykata si dhe falja e dhunuesit edhe pasi i’u ofrohen të gjitha shërbimet punësim, plotësim nevojash etj. - Sfidë ngelet gjithashtu dhe mungesa e bashkëpunimit nga ana e të dhunuarës 		
--	--	--	---	--	--

				<p>për tu fuqizuar. Dëshira e ulët e personave të dhunuar për të punuar pasi historiku i tyre tregon që kanë qenë të varur ekonomikisht nga burri duke refuzuar dhe mundësi punësimi që i'u ofrohen.</p> <p>- Arsimimi i ulët i personave që janë të dhunuar pasi i penalizon për t'u punësuar.</p>		
2.	12.01.2024	<p>1. Sa është shuma vjetore e shpenzuar nga Bashkia juaj për vitin 2023 për hostimin, domainin dhe shërbimet e faqes zyrtare web të Bashkisë Suaj? (në LEK)</p> <p>2. A ka bashkia juaj një program të miratuar transparence dhe nëse po kur është miratuar ai (viti)?</p> <p>3. Sa është numri i kërkesave për informim që kanë ardhur vetëm elektronikisht në bashkinë tuaj?</p>	26.01.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, ju bëjmë me dije se:</p> <p>1.Shuma e shpenzuar: Hostimi/domain - 100.000 lek dhe mirëmbajtje web-i 120.000 lek.</p> <p>2.Programi i transparencës është plotësuar dhe publikuar sipas modelit të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP). Programi i transparencës përditësohet në vazhdimësi me informacion sipas fushave të përcaktuara.</p> <p>3.Numri i kërkesave për informacion të cilat kanë ardhur elektronikisht është 35.</p>	E plotë	S'ka tarifë
3.	16.01.2024	<p>Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi burimin e hartës së VKM nr.398 datë 13.05.2020, cili institucion e ka miratuar dhe mbi çfarë baze ligjore e keni publikuar këtë hartë.</p>	29.01.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 16.01.2024, po ju vendosim në dispozicion përgjigjen e dhënë nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave, Bashkia Korçë:</p> <p>Burimi i hartës së VKM-së nr.398, datë 13.05.2020 janë hartat e vjetra të fondit pyjor dhe kullosor.</p>	E plotë	S'ka tarifë

4.	16.01.2024	<p>Kërkësë për t'u pajisur me informacion:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Sa është numri i akteve ligjore që keni konsultuar me organizatat jofitimprurëse gjatë vitit 2023? 2. Kush kanë qenë format e konsultimit që keni përdorur? 3. Sa është numri i OJF-ve që kanë marrë pjesë në këto konsultime? 4. A ka institucioni juaj koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik? Nëse po, ju lutem citoni kontaktin. 5. A ka institucioni juaj koordinator për shoqërinë civile? Nëse po, ju lutem citoni kontaktin. 6. A ka organe këshillimore që funksionojnë pranë institucionit tuaj? Nëse po, ju lutem listojini ato 7. A janë të përfshirë përfaqësues të OJF-ve në organe këshillimore të institucionit tuaj? Nëse PO, sa është numri i OJF-ve të përfshirë në to? 8. Gjatë 2023, a ka patur institucioni juaj grupe të përbashkëta pune me 	29.01.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 16.01.2024, sipas të dhënave të marra nga drejtoria përkatëse ju bëjmë me dije se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Çdo vit konsultohen projekt vendimet, paketa fiskale dhe buxheti. Në këto konsultime që zhvillohen me qytetarët marrin pjesë edhe OJF-të. 2. Takime të hapura. 3. Nuk mund të themi numrin e OJF-ve pjesëmarrëse në konsultimet publike, pasi nuk mbajmë listëprezencë. 4. Për Bashkinë Korçë koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik është Znj. Larisa Katundi. E-mail: larisakatundi5@gmail.com 5. Bashkia Korçë nuk ka koordinator për shoqërinë civile. 6. Po, Këshilli Vendor Rinor si edhe Këshilli Vendor i Sigurisë Publike. 7. Po. Pjesë e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike janë 3 (tre) përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile. 8. Në qytetin e Korçës ushtrojnë aktivitetin e tyre rreth 30 organizata të shoqërisë civile, të cilat zbatojnë projekte në fusha të ndryshme. Bashkia Korçë në bashkëpunim me UNDP dhe programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara "ReLOaD", ka ofruar mbështetje të vazhdueshme dhe mundësi bashkëpunimi për realizim projektesh apo iniciativash 	E plotë	S'ka tarifë
----	------------	--	------------	---	---------	-------------

		<p>pjesëmarrjen e OJF-ve? Nëse po, ju lutem përmendni: Qëllimin e grupeve Numrin e OJF-ve pjesëmarrëse Mënyra e përzgjedhjes së OJF-ve</p> <p>9. A është trajnuar stafi i institucionit tuaj mbi veprimtarinë dhe funksionimin e OJF-ve? Nëse po, sa punonjës janë trajnuar dhe nga kush?</p> <p>10. A ofron institucioni juaj licensa për shërbime të caktuara që ofrohen nga OJFtë? Nëse po, ju lutem specifikoni llojin/et e shërbimit? Sa është numri i OJFvë të licensuara sipas llojit/llojeve të shërbimit?</p>		<p>të përbashkëta me Organizatat e Shoqërisë Civile.</p> <p>Forma e dhënies së mbështetjes financiare për OSHC-të bazohet në “Metodologjinë LOD”, dokument i cili është përgatitur në kuadër të zbatimit të Projektit “ReLOaD”, i cili ka për qëllim përforcimin e demokracisë vendore të zbatuar në Bosnjë dhe Hercegovinë, zbatuar nga Programi për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP). Gjatë 3 Thirrjeve Publike të zhvilluara nga Bashkia Korçë për periudhën 2017-2022, Bashkia Korçë në bashkëpunim me UNDP ka mbështetur për zbatimin e projekteve 6 organizata, të cilat kanë zbatuar projektet e tyre brenda territorit të Bashkisë Korçë dhe pasur në fokus të tyre forcimin e demokracisë vendore, zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit, mjedisit, përfshirjen sociale të grupeve në nevojë, etj.</p> <p>Komisioni i Vlerësimit është organi përgjegjës për vlerësimin e projekt-propozimeve të dorëzuara nga OSHC-të në bazë të Thirrjeve Publike në Bashkinë Korçë. Pjesë e komisionit të vlerësimit është edhe një përfaqësues i Shoqërisë Civile, i cili zgjidhet me shumicë votash nga OSHC dhe së bashku me përfaqësues të Bashkisë, vlerëson dhe përzgjedh projektet fituese, që do të financohen brenda fondeve të disponueshme për</p>		
--	--	---	--	---	--	--

			<p>mbështetjen e OSHC. Projektet që kanë fituar numër më të madh të pikëve dhe kanë zbatuar udhëzimet e kerkuara sipas “Metodologjisë LOD” kanë prioritet për t’u përzgjedhur fituese.</p> <p>Udhëzimet mbi Thirrjet publike si edhe paketa e aplikimit publikohen në mënyrë transparente në rrjetet sociale dhe njoftimit përmes e-mail të OSHC, si edhe prezantohen në detaje edhe gjatë ditëve të hapura (takimeve) të organizuara midis Bashkisë Korçë dhe Organizatave të Shoqërisë Civile.</p> <p>Përfituese të mbështetjes jo financiare në qytetin e Korçës kanë qenë të gjitha organizatat lokale si edhe organizata të tjera, të cilat kanë qëllim realizimin e aktiviteteve të tyre në territorin e Bashkisë Korçë. Përmendim angazhimin dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me organizatat lokale, të cilat kanë qenë dashamirëse dhe teper bashkepunues në nisma dhe aktivitete të realizuara përmes bashkëpunimit të ngushtë me Bashkinë.</p> <p>Për vitin 2023, bazuar në thirrjen publike të Reload2 është mbështetur me fond nga Bashkia një organizatë fituese, nga tre aplikime gjithsej të dorëzuara në Bashkinë Korçë. Organizata fituese është duke zbatuar për një periudhë 6 mujore, projektin për artin dixhital dhe imersiv në Korçë. Më poshtë gjeni link të shpalljes</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>së thirrjes publike në kuadër të programit ReLOaD2: https://bashkiakorçe.gov.al/site/search.php?q=reload2 9. Jo, stafi i bashkisë nuk është trajnuar specifikisht mbi veprimtarinë dhe funksionimin e OJF-ve. 10. Jo, nuk ofrohen licenca nga institucioni jonë.</p>		
5.	24.01.2024	<p>Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi: 1.A është realizuar Muzeu i Rakisë në Boboshticë? 2.Në qoftë se JO, cilat kanë qenë arsyet e mosrealizimit të këtij premtimi? 3.A është planifikuar që ky muze të ndërtohet? Në qoftë se PO, në çfarë periudhe?</p>	29.01.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 24.01.2024, ju bëjmë me dije se: Projekti i ndërtimit të Muzeut Kombëtar të Rakisë në Boboshticë është një ide që Bashkia Korçë ka planifikuar ta realizojë në bashkëpunim dhe me financim të FSHZH-së, duke patur parasysh edhe rëndësinë që do të ketë ky muze si atraksion dhe në funksion të zhvillimit të turizmit jo vetëm në Boboshticë, por edhe si pjesë e paketave dhe guidave turistike në Bashkinë e Korçës. Nga ana e FSHZH-së ka filluar puna për hartimin e projekt idesë dhe projektit të zbatimit. Projekti tani është konceptuar edhe si pjesë e zhvillimit më të madh që do të ndodhë në zonën midis Drenovës dhe Boboshticës, i cili përfshin rikonstrukcionin e qendrave të Drenovës dhe Boboshticës, si dhe ndërtimin e një hapësire eventesh në këtë zonë. Ecuria e projektit do të përcaktohet nga angazhimi i FSHZH-së.</p>	E plotë	S'ka tarifë

6.	28.01.2024	<p>Kërkesë për t'u pajisur me informacion:</p> <p>1- Lista e gjithë pronave të paluajtshme që zotëron Bashkia e Korçës, ku të jenë përcaktuar gjithë të dhënat për secilën pronë, përfshi dhe vendodhjen e secilës prej tyre.</p> <p>2- Kopje e gjithë kontratave të dhënies me qira të pronave të paluajtshme që zotëron Bashkia e Korçës (ku Bashkia Korçë është në rolin e qiradhënësit).</p> <p>3- Kopje e gjithë kontratave të marrjes me qira të pronave të paluajtshme nga ana e Bashkisë së Korçës (ku Bashkia Korçë është në rolin e qiramarrësit).</p>	12.02.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 28.01.2024, sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, ju bëjmë me dije se:</p> <p>1. Listën përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të Bashkisë Korçë që transferohen, në pronësi ose në përdorim të saj i gjeni në VKM nr.1532 datë 19.11.2008 "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË KORÇË TË QARKUT TË KORÇËS". Bashkëngjitur VKM-së gjeni edhe listën e inventarit.</p> <p>2. Bashkia Korçë në rolin e qiradhënësit ka lidhur këto kontrata qiraje:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 29 kontrata qiraje për dhënie me qira objekte - 23 kontrata qiraje për dhënie me qira troje - 8 kontrata qiraje për dhënie me qira sipërfaqe toka bujqësore - 59 kontrata qiraje për dhënie me qira sipërfaqe nga fondi pyjor-kullosor <p>3. Nga ana e Bashkisë Korçë janë marrë me qira 6 pasuri të paluajtshme.</p>	E plotë	S'ka tarifë
----	------------	--	------------	---	---------	-------------

7.	11.02.2024	<p>Kërkesë për informacion mbi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. A ka bashkia programe për punësimin dhe aftësimin e të pastrehëve me qëllim adresimin e problematikës së vuajtur nga ky segment i shoqërisë? 2. A ka programe në vend për punësimin e tyre? 3. Sa persona të pastrehë kanë përfituar nga këto politika dhe programe? 4. Të çfarë forme janë këto programe? 5. Cilat janë sfidat në zbatimin e këtyre politikave? 6. Sa janë fondet buxhetore që institucioni rezervon për të zbatuar këto politika? 7. Çfarë programesh aplikoni për suportin, integrimin në shoqëri dhe tregut të punës, financime për këtë kategori shtrese në nevojë? 	21.02.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 11.02.2024, sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Strehimi Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale, ju bëjmë me dije se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. A ka bashkia programe për punësimin dhe aftësimin e të pastrehëve me qëllim adresimin e problematikës së vuajtur nga ky segment i shoqërisë? Bashkia zbaton programe të strehimit social dhe nëpërmjet kushteve për të përfituar strehim social nxitet nevoja për punësim. Në kuadër të bashkëpunimit dhe për t'ju ardhur në ndihmë shtresave në nevojë, Bashkia në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Punësimit Korçë ka përfshirë në programet e nxitjes të punësimit të zbatuara nga ana e tyre, rreth 30 individë nga skema e ndihmës ekonomike, punë në komunitet. Pra, nuk janë konkretisht persona të pastrehë, por persona të cilët përfitojnë ndihmë ekonomike të cilët mund të jenë dhe të pastrehë. 2. A ka programe në vend për punësimin e tyre? Bashkia bashkëpunon me Drejtorinë Rajonale të Punësimit për përfshirje në programe punësimi të kategorive në kushtet e nevojës për strehim. 3. Sa persona të pastrehë kanë përfituar nga këto politika dhe programe? 	E plotë	S'ka tarifë
----	------------	---	------------	---	---------	-------------

				<p>Kjo është një e dhënë që sigurohet nga Drejtoria Rajonale e Punësimit, në varësi të kriterit që ka ndjekur për punësim.</p> <p>4. Të çfarë forme janë këto programe? Aftësimi dhe përgatitja për profesione të ndryshme.</p> <p>5. Cilat janë sfidat në zbatimin e këtyre politikave? Sfida është ajo e arsimit profesional, vetëm nëpërmjet tij do të ketë mundësi punësimi dhe ofrim për të përfituar nga programet e strehimit social.</p> <p>6. Sa janë fondet buxhetore që institucioni rezervon për të zbatuar këto politika? Kjo nuk është kompetencë e drejtorisë së strehimit.</p> <p>7. Çfarë programesh aplikoni për suportin, integrimin në shoqëri dhe tregut të punës, financime për këtë kategori shtrese në nevojë? Kjo nuk është kompetencë e drejtorisë së strehimit.</p>		
8.	13.02.2024	<p>Kërkesë për informacion mbi:</p> <p>1. Cila është procedura që ndiqet për përfitimin e strehimit social dhe programeve mbështetëse nga qytetarët dhe cili është dokumentacioni që kërkohet?</p> <p>2. Për sistemin apo akordimin e përfitimeve sociale për personat a vepron Bashkia kryesisht me iniciativën e saj për</p>	21.02.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 13.02.2023, sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale Bashkia Korçë, ju bëjmë me dije se:</p> <p>1. Cila është procedura që ndiqet për përfitimin e strehimit social dhe programeve mbështetëse nga qytetarët</p>	E plotë	S'ka tarifë

		<p>sistemimin e tyre apo vepron gjithmonë mbi bazën e kërkesës së personave të interesuar?</p> <p>3.Sa është numri i personave të regjistruar si të pastrehë në Bashkinë e Korçës dhe cili është plani i zgjidhjes së problemit të tyre? A keni dijeni për raste të tjera por të paregjistruar si të tillë?</p> <p>4.Sa është numri i qytetarëve që kanë aplikuar për përfitimin e strehimit social apo programeve të ngjashme dhe si paraqitet raporti i përfituesve në raport me numrin e aplikantëve për periudhën referencë 2014-2024?</p> <p>5.Si paraqitet progresi i aplikimeve për përfitim përgjatë këtyre viteve në kuptim të rritjes apo zbritjes së numrit të aplikimeve/përfitimeve vit pas viti?</p> <p>6.Cilave kategori u përkasin përfituesit e skemës së strehimit social? (sipas nenit 16 të Lgjit Për Strehimin Social)</p> <p>7.A paraqitet të jetë strehim i përshtatshëm banesa në të cilën përfituesit janë akomoduar? (sipas nenit 4 të Lgjit Për Strehimin Social)</p>		<p>dhe cili është dokumentacioni që kërkohet?</p> <p>Procedura që ndiqet është ajo që përcaktohet në ligj, ligji 22/2018 "Për strehimin Social" i ndryshuar dhe në VKM 384 date 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore...Këto informacione janë të publikuara në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë (bashkiakorçe.gov.al). Aplikimi për të përfituar strehim social ka ndryshuar, kryhet online në sistemin e strehimit nëpërmjet platformës qeveritare e-Albania.</p> <p>2. Për sistemimin apo akordimin e përfitimeve sociale për personat a vepron Bashkia kryesisht me iniciativën e saj për sistemimin e tyre apo vepron gjithmonë mbi bazën e kërkesës së personave të interesuar?</p> <p>Veprimtaria për sistemim dhe akomodim realizohet dhe në bazë të kërkesave dhe në bazë të planit lokal 5 vjeçar 2021-2026 për strehimin social.</p> <p>3. Sa është numri i personave të regjistruar si të pastrehë në Bashkinë e Korçës dhe cili është plani i zgjidhjes së problemit të tyre? A keni dijeni për raste të tjera por të paregjistruar si të tillë?</p>		
--	--	--	--	--	--	--

		<p>8.A ka mjaftueshëm burime njerëzore pjesë e stafit të strehimit social?</p> <p>9.Cilat janë sfidat që has zyra e strehimit social në përmbushje të detyrave sipas ligjit?</p>	<p>Numri i personave të regjistruar si të pastrehë është përafërsisht 1350 familje, shifër e trashëguar në raportimet vjetore prej vitit 2018. Për raste të tjera referuar dhe familjeve të reja mendojmë se mund të ketë. Zgjidhja e problemit të strehimit lidhet me ndërthurjen e një komponenti tjetër me punësimin i cili e fut në rrugën e zgjidhjes strehimin dhe përfitimin nga programet e strehimit social të cilat zbatohen në Bashkinë Korçë.</p> <p>4. Sa është numri i qytetarëve që kanë aplikuar për përfitimin e strehimit social apo programeve të ngjashme dhe si paraqitet raporti i përfituesve në raport me numrin e aplikantëve për periudhën referencë 2014-2024?</p> <p>Për këtë duhet një studim më i thellë, referuar të dhënave në vitet që ju cilësoni.</p> <p>5. Si paraqitet progresi i aplikimeve për përfitim përgjatë këtyre viteve në kuptim të rritjes apo zbritjes së numrit të aplikimeve/përfitimeve vit pas viti?</p> <p>Vitet e fundit numri i përfituesve vjen në rritje nga viti në vit...psh në 2022 nga zbatimi i programeve të strehimit kanë përfituar rreth 78 familje, ndërsa në 2023 janë 129 familje.</p> <p>6. Cilave kategori u përkasin përfituesit e skemës së strehimit social? (sipas nenit 16 të Ligjit Për Strehimin Social)</p> <p>Personat me aftësi të kufizuara,</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>Familje e mbetur e pastrehë për shkak të lirim të banesave të ish-pronarëve, Familje të komunitetit Rom & Egjiptian, Prindërit e vetëm, që kanë në ngarkim fëmijë, me të ardhura shumë të ulta, Familje te reja, Individë me moshë nën 40 vjet, Të moshuar, Komunitet nga zonat rurale.</p> <p>7. A paraqitet të jetë strehim i përshtatshëm banesa në të cilën përfituesit janë akomoduar? (sipas nenit 4 të Lgjit Për Strehimin Social) Për të gjithë përfituesit nga programet e strehimit, rezulton që strehimi është i përshtatshëm.(sipas nenit 4 të Ligjit Për Strehimin Social)</p> <p>8. A ka mjaftueshëm burime njerëzore pjesë e stafit të strehimit social? Aktualisht stafi i drejtorisë së strehimit konsiderohet i mjaftueshëm, por në vazhdim në varësi të volumit të punës mund të shtohet me punonjës të tjerë.</p> <p>9. Cilat janë sfidat që has zyra e strehimit social në përmbushje të detyrave sipas ligjit? Sfida më e madhe është përballimi i nevojave për strehim të kategorisë vulnerabël me sistemim në banesa sociale që afrojnë një strehim të përshtatshëm, të përballueshëm dhe në përputhje me të drejtat për të patur akses për shërbime në arsimim, shërbime</p>		
--	--	--	--	---	--	--

				shëndetsore, infrastrukturë e shërbime komunale.		
9.	21.02.2024	<p>Kërkesë për tu pajisur me informacion mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bashkia në proceset e integrimit evropian. - Bashkia dhe shoqëria civile. - Të dhënat e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik. - Plani vjetor për procesin e vendimmarrjes me pjesëmarrje etj 	28.02.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 21.02.2024, ju bëjmë me dije se:</p> <p>Informacioni i kërkuar gjendet i publikuar në faqen zyrtare të web-it të Bashkisë Korçë, brenda Programit të Transparencës, sepse bën pjesë në kategorinë e informacioneve që bëhen publike pa kërkesë.</p> <p>1. Linku i Programit të Transparencës ku gjeni të publikuar të dhënat mbi "Bashkinë në proceset e integrimit evropian"- https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/informacion-tjet%C3%ABr/bashkia-n%C3%AB-proceset-e-integrimit-evropian?authuser=2</p> <p>2. Informacionin mbi pikën "Bashkia dhe shoqëria civile" e gjeni gjithashtu të publikuar në Programin e Transparencës, linku bashkangjitur: https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/informacion-tjet%C3%ABr/bashkia-dhe-shoq%C3%ABria-civile?authuser=2</p>	E plotë	Ska tarifë

				<p>3. Të dhënat e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik: Larisa Katundi E-mail: larisakatundi5@gmail.com Orari i punës: 08:00-16:00 Adresa: Kodi postar 7001, L.12, Blvd "Shën Gjergji", Nr.12, Korçë</p> <p>4.-5. Informacion mbi pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje e gjeni të publikuar brenda Programit të Transparencës. Linku bashkëngjitur: https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/pjes%C3%ABmarrja-qytetare-n%C3%AB-vendimmarrje?authuser=2</p> <p>- Adresa e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik: https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/pjes%C3%ABmarrja-qytetare-n%C3%AB-vendimmarrje/t%C3%AB-dh%C3%ABnat-e-koordinatorit-p%C3%ABr-njoftimin-dhe-konsultimin-publik?authuser=2</p> <p>- Plani vjetor: https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/pjes%C3%ABmarrja-qytetare-n%C3%AB-vendimmarrje/plani-vjetor-p%C3%ABr-procesin-e-vendimmarrjes-me-pjes%C3%ABmarrje?authuser=2</p> <p>- Procedura e marrjes dhe shqyrtimit të komenteve dhe rekomandimeve: https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/pjes%C3%ABmarrja-qytetare-n%C3%AB-vendimmarrje/procedura-e-</p>	
--	--	--	--	--	--

				marrjes-dhe-shqyrtimit-t%C3%AB-komenteve-dhe-rekomandimeve?authuser=2		
10.	21.02.2024	<p>Kërkesë për t'u pajisur me informacion për:</p> <p>1. A kanë përfituar OJF-të fonde publike nga institucioni juaj gjatë vitit 2023?</p> <p>1.1. Nëse po, cila ka qenë forma e përfitimit të këtyre fondeve (grant, kontrata shërbimi, prokurim publik/tenderim, etj.)?</p> <p>2. Sa OJF kanë aplikuar për fonde publike pranë institucionit tuaj gjatë vitit 2023? Ju lutem, specifikoni sipas formës, nëse ka patur më shumë se një formë.</p> <p>3. Sa OJF kanë përfituar nga këto fonde publike? Ju lutem, bashkëngjisni listën e fituesve së bashku me buxhetet përkatëse. Specifikoni sipas formës nëse ka patur më shumë se një formë</p> <p>4. Keni ofruar mbështetje jo-financiare për OJFtë gjatë vitit 2023? Nëse po, ju lutem specifikoni</p>	05.03.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 21.02.2024, ju bëjmë me dije se:</p> <p>Nga Bashkia Korçë kanë përfituar fonde publike 2(dy) OJF, Mary Potter dhe Misioni Emanuel.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mary Potter ka përfituar fonde publike në vlerën 1,755,076 lekë për energji, ujë, telefon, materiale konsumi dhe karburant, nëpërmjet marrëveshjes datë 02.02.2023. - Misioni Emanuel ka përfituar fonde publike nëpërmjet marrëveshjeve datë 28.12.2022 dhe 04.01.2023 midis Bashkisë Korçë -Misioni Emanuel - Këshilli i Qarkut Korçë në vlerën 3,000,000 lekë për menaxhimin e shërbimit tek Qendrat e moshës së tretë dhe në vlerën 1,000,000 lekë për menaxhimin e shërbimit tek Qendrat ditore për fëmijë. 	E plotë	S'ka tarifë

		<p>bazën ligjore/ rregullatore që rregullon këtë formë mbështetjeje?</p> <p>5. Nëse keni ofruar mbështetje jo-financiare gjatë vitit, sa OJF kanë përfituar nga kjo mbështetje? Cili ka qenë lloji i mbështetjes jo-financiare të ofruar (mjedise, trajnime, ndarje eksperiencash, etj)?</p>				
11.	07.03.2024	<p>Kërkesë për t'u pajisur me informacion:</p> <p>1-A bën, dhe më konkretisht sa insepktime periodike ka bërë Bashkia Korçë në territorin e qytetit gjatë vitit 2023 lidhur me tregtinë e paligjshme të duhanit?</p> <p>2-Sa produkt (duhan) i jashtëligjshëm është konstatuar dhe më pas sekuestruar nga institucioni juaj (nëse po) gjatë periudhës 01.01.2023 – 31.12.2023 në territorin e Bashkisë Korçë?</p> <p>3-Nëse ky produkt i konstatuar apo dhe sekuestruar (nëse po) do të nxirrej në treg, sa do të ishte fitimi i tregtarëve informalë?</p> <p>4-Përpos duhanit, a janë konstatuar materiale, sende apo</p>	16.03.2024	Bashkia Korçë nuk është institucioni kompetent për dhënien e përgjigjes, për këtë arsye e ka deleguar.	E deleguar	S'ka tarifë

		makineri që shërbejnë për prodhimin e paketave ose dhe përpunimin e duhanit?				
12.	12.04.2024	<p>Kërkesë për t'u pajisur me informacion:</p> <p>1-Sa është numri i fermerëve në bujqësi dhe pentari të dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore përgjatë vitit 2022-2023? 2-Ku kanë qenë dëmtimet më të mëdha në frutikulturë apo prodhimet bujqësore? 3-Sa është vlera e dëmeve të përlogaritura në këto dy vite, ju lutem për secilin vit specifikisht. 4-A ka bërë bashkia Korce dëmshpërblim të tyre? Nëse po në çfarë vlerë, nëse jo pse? 5-A ka bashkia Korce nisme apo program për të ardhmen në mbrojtje të fermerit.</p>	17.04.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 12.04.2024, sipas të dhënave të marra nga Sektori i Bujqësisë, Bashkia Korçë ju bëjmë me dije se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Numri i fermerëve të dëmtuar në bujqësi dhe pentari nga fatkeqësitë natyrore përgjatë viteve 2022-2023 bazuar në verifikimet e bëra nga zyra e bujqësisë është 18 fermerë në pentari dhe 14 fermerë në grurë dhe elb. 2. Dëmet më të mëdha kanë qenë në prodhimin e mollëve si pasojë e breshërit. 3. Gjatë vitit 2022 nuk kemi dëmtime. Dëmtimet janë gjatë vitit 2023. Dëmi i llogaritur ka qënë rreth 4850 kv mollë në 18 fermerë dhe 998 kv grurë dhe elb në 14 fermerë. 4. Bashkia nuk ka bërë dëmshpërblim sepse nuk ka fond të parashikuar për dëmet në prodhimet bujqësore. 5. Bashkia e ka në programin e saj mbrojtjen e fermerit dhe bashkëpunimin me ta, por për dëmtimet e vazhdueshme në bujqësi nga fenomenet ekstreme të motit si ngricat në pranverë dhe breshëri 	E plotë	S'ka tarifë

				është e domosdoshme të aplikohet siguracioni i prodhimit.		
13.	03.05.2024	<p>Kërkesë për t'u pajisur me informacion:</p> <p>1. Ka ndonjë rregullore apo standard aktual në fuqi të transpozuar nga vendet e Bashkimit Evropian që parasheh detyrimin e përfshirjes së strukturave ndihmëse për personat me aftësi të kufizuara në projektet e reja ndërtimore. Kjo do të përfshinte, por jo vetëm, rampat e qasjes, ashensorët e përshtatur, tualete të përshtatura dhe shenja orientuese për të verbërit.</p> <p>2. Nëse po si zbatohet monitorimi në ndërtesat e reja?</p> <p>3. Sa ndërtesa të reja e kanë implementuar rregulloren për këto struktura?</p> <p>4. Sa ndërtesa të reja publike (rikonstrutime/restaurime të godinave të vjetra) e kanë implementuar rregulloren për këto struktura?</p>	27.05.2024	<p>Përsëritje,</p> <p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit Bashkia Korçë, ju bëjmë me dije se: Ne nuk disponojmë në mënyrë të detajuar të dhënat të cilat kërkohen, pasi Bashkia Korçë nuk është organ që merret me hartimin e ligjeve që të dimë në mënyrë të detajuar nëse ligji ka për bazë ndonjë normativë të Bashkimit Evropian.</p> <p>Në sajë të kërkesës tuaj grupi i projektimit kreu një studim mbi objektet shtetërore të cilat ndodhen brenda Njërive Administrative të Bashkisë Korçë nga ku evidentoi:</p> <p>Objekte publike që ndodhen në të gjitha njësitë administrative të qytetit të Korçës të cilat janë të aksesueshme nga persona PAK janë vendosur në dispozicion për kerkuesin në formë tabelore.(nuk mund ta ngarkojmë këtu)</p> <p>Objektet janë të aksesueshme nëpërmjet rampave ose hyrja e tyre bëhet menjëherë</p>		

		<p>5. Sa ndërtesa të reja rezidenciale e kanë implementuar rregulloren për këto struktura?</p> <p>6. Sa ndërtesa të reja tregtare e kanë implementuar rregulloren për këto struktura?</p> <p>7. Sa ndërtesa e kanë implementuar rregulloren për daljen emergjente për këto struktura?</p>		<p>në katin përdhe pa shkallë siç janë disa Qendra Shëndetësore në njësitë administrative. Objekte që janë të pajisura me ashensor janë 4. Objekte që janë të pajisura me tualet për PAK rezultojnë 2.</p> <p>Për shkak se kthimi i kësaj përgjigje kërkonte studim në terren na u nevojiti një afat më i gjatë kohor.</p>		
14.	06.05.2024	<p>Kërkesë për t'u pajisur me informacio: 1.Sa është numri i të punësuarve të Bashkisë Korçë për vitin 2024 dhe sa ka qënë ky numër në vitin 2013 përfshirë të gjitha drejtoritë në varësi; 2. Sa është fondi i bashkisë për përbalimin e pagave të punonjësve; 3. Një listë e të punësuarve të kësaj bashkie për vitin 2024.</p>	15.05.2024	<p>Bazuar në email-in tuaj datë 06.05.2024, ju informojmë se gjithë informacioni/dokumentacioni që ne kishim detyrim ligjor që ta bëjmë publik, ja u kemi dërguar me shkresën nr. prot. 2186/1 datë 21.03.2024.</p> <p>Për sa i përket fondit të pagave për muajt Janar-Prill 2024, plan është 86,312,589 lekë dhe fakt 65,704,930 lekë.</p>	E plotë	S'ka tarifë
15.	07.05.2024	<p>Kërkesë për t'u pajisur me informacion:</p> <p>1.Sa është numri i stacioneve të MZSH në bashkinë tuaj?</p> <p>2.Sa është numri total i makinave zjarrfikëse në bashkinë tuaj ?</p> <p>3.Sa është numri i efektivëve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit (zjarrfikës dhe punonjës)</p>	08.05.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 07.05.2024, sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit ju bëjmë me dije se:</p> <p>1. Numri i stacioneve të MZSH-së Bashkia Korçë është 1 (një).</p> <p>2. Numri total i automjeteve zjarrfikëse në gatishmëri është 7 (shtatë), nga këto 6 (gjashtë) automjete zjarrfikëse dhe një</p>	E plotë	S'ka tarifë

		<p>4. Cilit vit i përkasin automjetet zjarrfikëse dhe a mund të specifikoni nëse janë blerë nga fondet e bashkisë apo donacionet?</p> <p>5. A ka Bashkia plane afatshkurtra për blerje mjetesh të reja apo investime lidhur me këtë program?</p>		<p>automjet shpëtimi të kompletuara me pajisje.</p> <p>3. Numri total i efektivit është 35 punonjës.</p> <p>4. Automjetet zjarrfikëse i përkasin viteve 1998 -2021, nga këto 2 (dy) automjete zjarrfikëse janë blerë me fondet e Bashkisë dhe 5 (pesë) të tjera janë donacione.</p> <p>5. Për vitin 2024 është planifikuar blerja e një automjeti zjarrfikës (autoskollë) si dhe pajisje zjarrfikëse dhe pajisje për shpëtim.</p>		
16.	20.05.2024	<p>Kërkesë për t'u pajisur me informacion: Aktualisht, sa persona që i përkasin komuniteti rom dhe egjiptian ndodhen në Bashkinë e Korcës? A keni informacion se sa prej tyre janë të strehuar?</p> <p>A është ofruar mbështetje për familjet rome dhe egjiptiane përmes subvencionimit të qirasë në treg për vitin 2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023? Nëse po, për sa persona?</p> <p>A ka përfituar Bashkia Korcë mbështetje financiare nga qeveria qendrore për përmirësimin e kushteve të strehimit të minoriteteve rome dhe egjiptiane për periudhën</p>	24.05.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 20.05.2024, sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Strehimit dhe Menaxhimit të Banesave Sociale me Qera, ju bëjmë me dije se:</p> <p>1. Aktualisht, sa persona që i përkasin komuniteti rom dhe egjiptian ndodhen në Bashkinë e Korcës? A keni informacion se sa prej tyre janë të strehuar.</p> <p>-Numri i personave që i përkasin komuniteteve rom dhe egjiptian mund të dalë nga censusi i INSTAT.</p> <p>Nga programet e strehimit kanë përfituar rreth 221 familje duke u nisur nga të dhënat që drejtoria e strehimit për periudhën 2019-2023.</p> <p>2. A është ofruar mbështetje për familjet rome dhe egjiptiane përmes subvencionimit të qirasë në treg për vitin</p>		

		<p>2020 – 2023? Nëse po, në çfarë vlerë? Sa familje/persona që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian përfitojnë nga programet e strehimit në Bashkinë e Korcës? Sa ka qënë ky numër për vitet 2020, 2021, 2022, 2023? A ka një nismë nga Bashkia Korçë për të legalizuar vendbanimet joformale te komunitetit rom dhe egjiptian? A ka ofruar Bashkia asistencë në plotësimin e dokumentacionit për aplikim për programin social të strehimit për anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian përgjatë periudhës 2020 - 2023? Nëse po, për sa raste? Kush i ka mbuluar shpenzimet e aplikimit? A ka miratuar Bashkia Korçë një plan 5 vjecar mbi strehimin? Nëse po, ju lutem na i vendosni në dispozicion.</p>		<p>2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023? Nëse po, për sa persona? Po, përkatësisht: 2019 janë mbështetur 5 familje (1 rome, 4 egjiptiane) 2020 janë mbështetur 6 familje (2 rom 2021 janë mbështetur 6 familje (1 rome, 4 egjiptiane) 2022 janë mbështetur 7 familje (2 rome, 5 egjiptiane) 2023 janë mbështetur 6 familje (2 rome, 4 egjiptiane). 3.A ka përfituar Bashkia Korçë mbështetje financiare nga qeveria qëndrore për përmirësimin e kushteve të strehimit të minoriteteve rome dhe egjiptiane për periudhën 2020 – 2023? Nëse po, në çfarë vlerë? Po, Bashkia Korçë ka përfituar mbështetje financiare për përmirësimin e kushteve të strehimit për familjet e komuniteteve të varfëra dhe të pafavorizuara, në të cilën përfshihen dhe kategoria e familjeve nga komuniteti Rom dhe Egjiptian. Vlerat e përfituara kanë qënë në bashkëfinancim me buxhetin e shtetit në masën 65% e kostos se projektit për çdo vit referuar periudhës 2020-2023. 4.Sa familje/persona që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian përfitojnë nga programet e strehimit në Bashkinë e</p>		
--	--	---	--	---	--	--

				<p>Korcës? Sa ka qënë ky numër për vitet 2020, 2021, 2022, 2023?</p> <p>Nga programet e strehimit social në Bashkinë e Korçës kanë përfituar rreth 350 familje të komuniteteve Rom dhe Egjiptian përfshi këtu dhe nga zbatimi i programit të “Përmirësimit të kushteve të banimit për familjet që banojnë në zona të varfëra dhe të pafavorizuara”.</p> <p>Të ndara sipas periudhave të sipërpërmendura janë:</p> <p>2020 janë mbështetur 62 familje, 2021 janë mbështetur 85 familje, 2022 janë mbështetur 94 familje, 2023 janë mbështetur 109 familje.</p> <p>5.A ka një nismë nga Bashkia Korçë për të legalizuar vendbanimet joformale te komunitetit rom dhe egjiptian? Kjo çështje, legalizimi nuk është në kompetencat e Bashkisë.</p> <p>6.A ka ofruar Bashkia asistencë në plotësimin e dokumentacionit për aplikim për programin social të strehimit për anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian përgjatë periudhës 2020 - 2023? Nëse po, për sa raste? Kush i ka mbuluar shpenzimet e aplikimit?</p> <p>Bashkia Korçë me anë të sportelit më një ndalesë ka ofruar asistencë në plotësimin e dokumentacionit dhe për kryerjen e aplikimit ”Kërkesë për të përfituar nga programet sociale të strehimit” në sistemin online nëpërmjet portalit</p>	
--	--	--	--	--	--

				<p>qeveritar E-Albania. Asistenca është ofruar për të gjitha rastet, shpenzimet e aplikimit për familjet pa të ardhura janë mbuluar nga buxheti i Bashkisë Korçë.</p> <p>7.A ka miratuar Bashkia Korçë një plan 5 vjeçar mbi strehimin? Nëse po, ju lutem na i vendosni në dispozicion.</p> <p>Bashkia Korçë ka miratuar planin 5-vjeçar 2021-2026 me vendim të Këshillit Bashkiak Nr.98 datë 26.08.2021 “Për Miratimin e Planit Lokal “Programi 5-vjeçar i Strehimit Social 2021-2026” për Bashkinë Korçë”. Këtë vendim e gjeni të publikuar në faqen zyrtare të vendimeve Vendime.al</p>		
17.	20.05.2024	<p>Kërkesë për t’u pajisur me informacion:</p> <p>1) Emrin, kontaktet e Koordinatorit të njoftimit dhe konsultimit publik dhe kopje të vendimit të emërimit të tij.</p> <p>2) Linkun e regjistrimit elektronik ku janë publikuar Projektaktet, e njoftimit për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projektakteve sipas detyrimit të percaktuar në nenin 6, pika 1, germa a) e ligjit Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik". 3) Kopje të planeve vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e</p>	28.05.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 20.05.2024, ju bëjmë me dije se:</p> <p>1. Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik Larisa Katundi E-mail: larisakatundi5@gmail.com Adresa: L.12, Bulevard " Shën Gjergji", Nr.12 (Bashkia Korçë) Bashkëngjitur po ju vendosim në dispozicion kopjen e vendimit të emërimit të tij.</p> <p>2. Link-u i regjistrimit elektronik të projektakteve për konsultim publik si edhe projekt vendimet e Këshillit Bashkiak:</p> <p>https://docs.google.com/spreadsheets/d/1</p>	E plotë	S’ka tarifë

		vendimmarrjes, të publikuara në programin e transparencës, sipas ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".		<p>UYq08gHYMKzLUkpFPmSmrxxgp-eEa5kX1rWOO3cgW5c/edit#gid=0 https://bashkiakorçe.gov.al/site/articles.php?cid=419&t=Projekt-Vendime 3. Link-u ku gjeni të publikuar planin e konsultimeve të Këshillit Bashkiak si edhe kalendarin e konsultimeve publike të zhvilluara për Paketën Fiskale dhe Buxhetimin me Pjesëmarrje https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/pjes%C3%ABmarrja-qytetare-n%C3%AB-vendimmarrje/plani-vjetor-p%C3%ABr-procesin-e-vendimmarrjes-me-pjes%C3%ABmarrje?authuser=0 Gjithashtu, VKB-ja Nr.156 datë 07.12.2023, "Për miratimin e planit të aktiviteteve dhe planit të konsultimeve publike 2024 të Këshillit Bashkiak Korçë" si edhe VKB-ja Nr.10 datë 25.01.2024 "Për miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për institucionet e Bashkisë Korçë për vitin 2024".</p>		
18.	21.05.2024	<p>Kërkesë për t'u pajisur me informacion: 1) Mënyrat e njoftimit gjatë procesit të konsultimit publik a) me postë elektronike; b) me lajmërim publik, i cili afishohet në ambientet e organit publik iniciues;</p>	28.05.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 21.05.2024, ju bëjmë me dije se: 1. Mënyra e njoftimit gjatë procesit të konsultimit publik bëhet me lajmërim publik i cili afishohet në stendën e Bashkisë Korçë si edhe me publikim në faqen zyrtare të web-it www.bashkiakorçe.gov.al, në kategorinë "Njoftime".</p>	E plotë	S'ka tarifë

		<p>c) me një lajmërim në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale;</p> <p>ç) me botimin në gazeta lokale ose në dy gazetat më të lexuara në nivel kombëtar.</p> <p>2) Mënyrat e marrjes së komenteve dhe rekomandimeve gjatë procesit të konsultimit publik</p> <p>a) me postë elektronike;</p> <p>b) në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike;</p> <p>c) Tjetër</p> <p>3) A ka patur raste kur është zgjatur ose përsëritur faza e konsultimit?</p> <p>4) Nëse Po, ju lutem na dërgoni arsyet si dhe kopje të aktit për të cilin është zgjatur ose përsëritur faza e konsultimit.</p> <p>5) Kopje të njoftimit për takime publike.</p> <p>6) Kopje të Procesverbaleve të takimeve publike të zhvilluara gjatë periudhës shtator 2023-maj 2024.</p> <p>-</p> <p>7) Kopje të Projektakteve të miratuara gjatë periudhës shtator 2023 maj 2024 shoqëruar me një</p>		<p>2. Komentet dhe rekomandimet merren në formë verbale dhe me shkrim të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike.</p> <p>3-4. Jo.</p> <p>5. Njoftimi për konsultimet publike bëhet në kategorinë "Njoftime", në faqen e web-it www.bashkiakorke.gov.al .</p> <p>Kategoria Njoftime tek rubrika "Këshilli Bashkiak", link-u bashkëngjitur: https://bashkiakorke.gov.al/site/articles.php?cid=388&t=Njoftimet</p> <p>Gjithashtu, në programi i transparencës link-u bashkëngjitur:</p> <p>https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/pjes%C3%ABmarrja-qytetaren%C3%AB-vendimmarrje/njoftimi-p%C3%ABr-nism%C3%ABn-vendimmarr%C3%ABse-me-pjes%C3%ABmarrje?authuser=0</p> <p>6. Kopjet e proces verbaleve i gjeni bashkëngjitur: https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/pjes%C3%ABmarrja-qytetaren%C3%AB-vendimmarrje/procedura-e-marrjes-dhe-shqyrtimit-t%C3%AB-komenteve-dhe-rekomandimeve?authuser=0</p> <p>7. Projektaktet e miratuara janë të publikuara në vendime.al , link-u bashkëngjitur: https://www.vendime.al/korce/ .</p>		
--	--	---	--	---	--	--

		<p>përmbledhje të rekomandimeve të pranuar, dhe përmbledhje të arsyeve për rekomandimet e palëve të interesuara që nuk janë pranuar në zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik". 8) Kopje të Raportit vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes për vitin 2023.</p> <p>9) Nëse ka patur ankesa në lidhje me procesin për njoftim dhe konsultim publik. Nëse PO, ju lutem na dërgoni kopje të ankesave.</p>		<p>8. Po ju vendosim në dispozicion një kopje të "Raportit vjetor për transparencën" nga Faktoje.al</p> <p>9. Nuk ka pasur ankesa.</p>		
19.	27.05.2024	<p>Kërkesë për t'u pajsiur me informacion: 1. Sa është numri total i banorëve në Bashkinë Korçë, të ndarë sipas Njësive Administrative?</p> <p>2. Sa është numri i banorëve që i përkasin pakicës kombëtare rome dhe numri i banorëve që i përkasin pakicës kombëtare egjiptiane, të ndarë sipas Njësive Administrative?</p> <p>3. Sa është numri i institucioneve të arsimit parauniversitar publik (shkollave 9-vjeçare dhe</p>	05.06.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 30.05.2024, sipas të dhënave të marra nga drejtoritë përkatëse ju bëjmë me dije se:</p> <p>1. Numri total i banorëve në Bashkinë Korçë është 87.846. Numri i banorëve të Njësive Administrative është 41.160.</p> <p>2. Këtë të dhënë nuk e disponojmë.</p> <p>4. Numri i familjeve përfituese të ndihmës ekonomike është 735 familje, nga të cilat 375 familje i përkasin pakicës kombëtare rome dhe egjiptiane.</p>	E plotë	S'ka tarifë

		<p>shkollave të mesme) në territorin në juridiksionin e Bashkisë Korçë? Ju lutem na informoni në lidhje me emërtimet e tyre, vendodhja (adresat), si dhe distancat me njëra tjetrën të institucioneve arsimore?</p> <p>4. Sa është numri i përfituesve të ndihmës ekonomike në Bashkinë Korçë dhe sa prej përfituesve i përkasin pakicës kombëtare egjiptiane dhe sa pakicës kombëtare rome?</p> <p>5. Çfarë shërbimesh dhe/ose forma mbështetje (bursa ose mbështetje të çfarëdolloj natyre) ofrohen nga ana e Bashkisë Korçë, me qëllim sigurimin e të drejtës për arsim, të nxënësve të cilët ndjekin arsimin në institucionet e arsimit parauniversitar publik, në territorin në juridiksionin e bashkisë?</p> <p>6. Sa është numri i nxënësve të cilët përfitojnë nga shërbimet dhe/ose mbështetja e ofruar nga Bashkia Korçë, për vitin arsimor 2022-2023 dhe 2023-2024, sipas llojit të</p>		<p>Pergjigjet per pyetjet 3,5,6 i gjeni bashkangjitur (te marra nga NSHMAÇ) Pyetjet 7,8 janë të paqarta.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

		<p>shërbimit/mbështetjes dhe kategorive përfituese të nxënësve? Sa prej përfituesve i përkasin pakicës kombëtare rome dhe sa i përkasin pakicës kombëtare egjiptiane?</p> <p>7. Cilat janë politikat dhe strategjitë që ka ndërmarrës Bashkia Korçë në zbatim të këtyre masave, brenda kompetencës së ministrisë që ju drejtoni?</p> <p>8. A ka realizuar Bashkia Korçë ndonjë monitorim në lidhje me këtë çështje? Nëse Po, Cilat janë gjetjet dhe rekomandimet? Sa efektive kanë qenë?</p>				
20.	03.06.2024	<p>1. A ka pasur Bashkia juaj buxhet vjetor të planifikuar për rininë (grup moshën 15-29 vjeç) për periudhën janar -dhjetor 2023? Nëse po, sa përqind të shumës totale të buxhetit zënë këto zëra? Nëse jo, ju lutem a mund të na tregoni disa nga arsyet përse nuk ka një planifikim të tillë?</p> <p>2. Sa është numri total i punonjësve në Bashkinë tuaj (2023)? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Sa</p>	12.06.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 03.06.2024, sipas të dhënave të marra nga drejtoritë përkatëse ju bëjmë me dije se:</p> <p>1. A ka pasur bashkia juaj buxhet vjetor të planifikuar për rininë (grup moshën 15-29 vjeç) për periudhën janar-dhjetor 2023? Nëse po, sa përqind të shumës totale të buxhetit zënë këto zëra? Nëse jo, ju lutem a mund të na tregoni disa nga arsyet përse nuk ka një planifikim të tillë?</p> <p>Buxheti për rininë nuk buxhetohet më vete, por vlera e buxhetit përcaktohet në bazë të programeve buxhetore për çdo njesi shpenzuese të specifikuar nga</p>	E plotë	S'ka tarifë

		<p>prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara, edhe sipas gjinisë?</p> <p>3. Sa është numri i të rinjve (18-29) punonjës të bashkisë tuaj në vitin 2023? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara, edhe sipas gjinisë?</p> <p>4. Sa është numri i të rinjve (18-29) të punësuar në bashkinë tuaj, të cilët mbajnë pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse? (zv.kryetar, drejtor, etj). Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara, edhe sipas gjinisë?</p> <p>5. A ka Bashkia juaj politika rinore të zhvillura specifikiht për grup moshën 15-29 vjeç? Nëse jo, ju lutem a mund të na tregoni disa nga arsyet përse nuk ka të zhvilluar një politikë të tillë?</p> <p>6. A keni në institucionin tuaj, drejtori, sektorë, staf të dedikuar për rininë? Prej sa kohësh janë funksionale?</p> <p>7. A ka struktura rinore të ngritura në Bashkinë tuaj dedikuar grupmoshës së të rinjve</p>		<p>Bashkia Korçë për projektet që zbatohen, konkretisht: Programi i arsimit bazë; programi i arsimit të mesëm të përgjithshëm; programi i arsimit profesional; programi sport dhe argëtim ku perfshihen të rinjtë.</p> <p>2. Sa është numri total i punonjësve në Bashkinë tuaj? (2023) Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara, edhe sipas gjinisë? Numri total i punonjësve në Bashkinë Korçë për vitin 2023 është 268. Prej të cilëve 151 janë meshkuj dhe 117 femra. Nuk ka me aftësi të kufizuara asnjë punonjës.</p> <p>3. Sa është numri i të rinjve (18-29) punonjës të bashkisë tuaj në vitin 2023? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara, edhe sipas gjinisë? Numri i të rinjve punonjës të Bashkisë Korçë për vitin 2023 (18-29 vjeç) është 44. Prej të cilave 27 femra dhe 17 meshkuj.</p> <p>4. Sa është numri i të rinjve (18-29) të punësuar në bashkinë tuaj, të cilët mbajnë pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse? (zv. kryetar, drejtor, etj). Sa prej tyre janë femra dhe sa janë</p>		
--	--	---	--	--	--	--

		<p>15-29 vjeç (qendra/zyra rinore, këshilla rinore, parlament rinor, struktura konsultative rinore, etj.) për periudhën janar - dhjetor 2023. Nëse po, cilat janë ato?</p> <p>8. Me kë keni bashkëpunuar për ngritjen e strukturave të tilla (organizata rinore, grupe të rinjsh, individë, etj)</p> <p>9. A keni një plan veprimi për Këshillin Rinor Vendor (KVR)? Sa aktivitete janë organizuar nga KVR përgjatë 2023?</p> <p>10. Sa të rinj janë të përfshirë në KVR? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara, edhe sipas gjinisë?</p> <p>11. A keni pasur ju forma të tjera bashkëpunimit (me grupe të rinjsh, organizata rinore, etj) për zhvillimin e aktiviteteve me fokus rininë? Nëse po ku kanë konsistuar ato?</p> <p>12. Sa është me përafërsi pjesëmarrja e të rinjve në konsultimet publike të zhvilluara nga bashkia? Cilat janë disa nga mjetet apo mekanizmat që përdor bashkia në përfshirjen e të rinjve në të tilla procese?</p>		<p>meshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara, edhe sipas gjinisë?</p> <p>Asnjë.</p> <p>5. A ka Bashkia juaj politika rinore të zhvilluara specifikisht për grup moshën 15-29 vjeç? Nëse jo, ju lutem a mund të na tregoni disa nga arsyet përse nuk ka të zhvilluar një politikë të tillë?</p> <p>Bashkia Korçë e ka konsideruar rininë si një nga prioritetet kryesore, duke krijuar ura bashkëpunimi me institucione dhe organizata jo-fitimprurëse. Janë hartuar projekte dhe aktivitete me fokus të rinjtë dhe ka qënë gjithmonë mikpritëse për të rinjtë. Bashkëpunimi me këto organizata ka bërë të mundur hartimin dhe implementimin e projekteve për t'ju dhënë zgjidhje problematikave lokale rinore. Gama e mbështetjes së të rinjve nga ana e bashkisë është e gjerë dhe kap shumë dimensione si nxitja për punësim, edukimi, sporti, kultura, vullnetarizmi etj. Qendra Sportive Korçë është një tjetër hapësirë multifunksionale, ku të rinjtë e grupmoshave të ndryshme zhvillojnë talentet e tyre në një gamë të gjerë disiplinash sportive. Vlen të përmendet investimi më i fundit i Bashkisë Korçë, Korça Innovation Technology Hub, ku zhvillohen kurse, trajnime në fushën e programimit, teknologjisë dhe</p>		
--	--	---	--	--	--	--

		<p>13. Lutemi listoni mjetet e komunikimit që përdor bashkia juaj dhe link përkatëse të faqes së webit të bashkisë (website) dhe rrjetet sociale si Facebook dhe Instagram.</p> <p>14. Sa është numri total i përfituesve nga Skema e Ndhmës Ekonomike për vitin 2023? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj?</p> <p>15. Sa është numri e të rinjve (15-29 vjeç) përfitues nga Skema e Ndhmës Ekonomike për vitin 2023? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj?</p> <p>16. Sa është numri total i përfituesve të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar për vitin 2023? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj?</p> <p>17. Sa është numri e të rinjve (15-29 vjeç) përfitues të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar për vitin 2023? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj?</p> <p>18. Sa është numri total i personave të cilat janë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2023?</p>		<p>menaxhimit të rrjeteve sociale. Ky hub ju ofron mundësi të rinjve për t'u kualifikuar dhe më pas të punësohen në këtë treg, në botën digjitale.</p> <p>Plani Lokal i Veprimit për Rininë është hartuar në bashkëpunim me Bashkinë e Korçës, falë mbështetjes së plotë të Fondacionit Friedrich Ebert, i cili mbështet zhvillimin e politikave rinore në nivel vendor dhe qendror, në bashkëpunim me Kongresin Rinor Kombëtar. Ky plan shërben si një bazë orientuese politikash dhe veprimtarie të dedikuar për sektorin e rinisë, në përputhje të plotë me perceptimet dhe vizionin që të rinjtë dhe institucionet kanë mbi perspektivën lokale.</p> <p>https://www.festirana.org/fileadmin/user_upload/documents/Plani_lokal_i_veprimit_per_rinine_2020-2023_Korce.pdf</p> <p>Plani Lokal i Veprimit për Rininë është fokusuar në 6 prioritete, që janë përcaktuar si prioritete të rëndësishme edhe për Bashkinë e Korçës, të cilat janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës; 2- Punësimi dhe sipërmarrja rinore 3- Pjesëmarrja dhe përfaqësimi rinor; 4- Art, sport, kulturë dhe mjedisi; 		
--	--	---	--	---	--	--

		<p>Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj? 19. Sa është numri i të rinjve (15-29 vjeç) të cilat janë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2023? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj?</p>		<p>5- Mbështetja e organizatave dhe nismave rinore;</p> <p>6- Çështjet sociale, shëndetësore dhe shërbimet publike për të rinjtë.</p> <p>6. A keni në institucionin tuaj, drejtori, sektorë, staf të dedikuar për rininë? Prej sa kohësh janë funksionale?</p> <p>7. A ka struktura rinore të ngritura në Bashkinë tuaj dedikuar grupmoshës së të rinjve 15-29 vjeç për periudhën janar-dhjetor 2023. Nëse po, cilat janë ato?</p> <p>6-7. Bashkia Korçë ka ngritur Këshillin Vendor të Rinisë me vendim të Këshillit Bashkiak nr.122 datë 29.07.2022. Krijimi i një vendi të dedikuar për rininë (Janar 2021) brenda Kabinetit të Kryetarit të Bashkisë është një tregues për rëndësinë e kësaj grupmoshe në prioritetet e bashkisë. Përmendim sektorin e teknologjisë dhe inovacionit i cili është i dedikuar në trajnimin dhe punësimin e të rinjve në fushën e përmendur.</p> <p>8. Me kë keni bashkëpunuar për ngritjen e strukturave të tilla (organizata rinore, grupe të rinjsh, individë, etj) Agjencia Kombëtare e Rinisë, Këshilli Studentor Universiteti “Fan S. Noli” , qeveritë e nxënësve, organizatat lokale.</p>		
--	--	--	--	---	--	--

			<p>9. A keni një plan veprimi për Këshillin Rinor Vendor (KVR)? Sa aktivitete janë organizuar nga KVR përgjatë 2023? Këshilli Vendor Rinor mblidhet të paktën 3 herë në vit, ku diskutohen çështje të ndryshme në lidhje me rininë në qytetin e Korçës.</p> <p>10. Sa të rinj janë të përfshirë në KVR? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara, edhe sipas gjinisë? Këshilli Vendor Rinor është i përbërë nga 10 anëtarë prej të cilëve 5 meshkuj, 5 femra.</p> <p>11. A keni pasur ju forma të tjera bashkëpunimi për zhvillimin e aktiviteteve me fokus rinine? Nëse po, ku kanë konsistuar ato? Të gjitha aktivitetet rinore, proceset konsultative, projektet me në fokus rininë të listuara më sipër, Bashkia Korçë bashkëpunon me institucione/organizata në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Përmendim aktivitetet:</p> <ul style="list-style-type: none"> · Projekti “Bursa për gjimnazistët”, që konsiston në vlerësimin moral dhe financiar të nxenesve ekselente nga gjimnazet e Bashkisë Korçë. 	
--	--	--	--	--

				<ul style="list-style-type: none">· Panairi i punës “Career Tech” është pjesë e programit të madh të Bashkisë Korçë për ta kthyer qytetin në qendrën më të madhe teknologjike në rajon, duke ofruar mundësi punësimi për të rinjtë e Korçës. Korca Innovation Hub është një dritare e madhe teknologjike që u ofrohet të rinjve të Korçës, në teknologji, inovacion dhe sipërmarrje.· Projekti “Upshift” është një program i cili ka si qëllim rritjen e mundësive për të rinjtë duke siguruar rritjen e mirëqënies nëpërmjet punësimit dhe sipërmarrjes. Ky program përmirëson gatishmërinë profesionale dhe kapacitetet e sipërmarrjes, për sa i përket aftësive të transferueshme dhe eksperiencave profesionale tek të rinjtë.· Projekti “Ponder” është një program social rinor nga UNICEF Albania në bashkëpunim me ICTSlab dhe mbështetjen e Bashkisë Korçë. Ky program ka si qëllim të nxisë tek të rinjtë aftësinë e të menduarit kritik, veçanërisht në lidhje me informacionet që marrin nga të gjitha llojet e mediave.· Të rinj nga e gjithë Shqipëria janë bërë pjesë e një prej akademive më të mëdha të inovacionit në vendin tonë,		
--	--	--	--	--	--	--

			<p>“Korça ICT Academy”. Në kuadër të bashkëpunimit të Bashkisë Korçë dhe partnerë të tjerë, 110 të rinj i janë bashkuar kampit veror të kodimit në Korçë, ku nën drejtimin e 10 instruktorëve amerikanë nga Universiteti i Standford mësojnë se si të programojnë në Python dhe Android dhe se si të zbatojnë me efikasitet të menduarit kritik.</p> <p>12. Sa është me përfaqësi pjesëmarrja e të rinjve në konsultimet publike të zhvilluara nga bashkia? Cilat janë disa nga mjetet apo mekanizmat që përdor bashkia në përfshirjen e të rinjve në të tilla procese? Përqindja e të rinjve në konsultimet publike është afërsisht 25%. Njoftimi i të rinjve bëhet nëpërmjet rrjeteve tona sociale si edhe faqes zyrtare të web-it, pasi kjo grupmoshë është më tepër aktive në përdorimin e tyre.</p> <p>13. Lutemi listoni mjetet e komunikimit që përdor bashkia juaj dhe link përkatëse të faqes së webit të bashkisë dhe rrjetet sociale si Facebook dhe Instagram. Faqja e webit: https://bashkiakorce.gov.al/site/ Facebook: https://www.facebook.com/BashkiKorce/?locale=sq_AL</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>https://www.facebook.com/filosotiraq/?locale=sq_AL Instagram: https://www.instagram.com/sotiraqfilo?igsh=MXdyYXoydmtiNWg3dQ== https://www.instagram.com/bashkia_korce/?igsh=d29hZzZudTZibnN4</p> <p>14.Sa është numri total i përfituesve nga Skema e Ndhmës Ekonomike për vitin 2023? Sa prej tyre janë femra dhe meshkuj? Nga Skema e Ndhmës Ekonomike për vitin 2023 përfitojnë 753. 700 prej tyre i përkasin gjinisë femërore dhe 53 i përkasin gjinisë mashkullore.</p> <p>15.Sa është numri i të rinjve (15-29 vjet) përfitues nga Skema e Ndhmës Ekonomike për vitin 2023? Sa prej tyre janë femra dhe meshkuj? Numri total i të rinjve 15-29 vjeç përfitues nga skema e ndihmës ekonomike për vitin 2023 është 75 përfitues. Nga këto 40 i përkasin gjinisë mashkullore dhe 35 i përkasin gjinisë femërore.</p> <p>16.Sa është numri total i përfituesve të PAK për vitin 2023? Sa prej tyre janë femra dhe meshkuj? Përfitues total të PAK për vitin 2023 janë 2097 përfitues.169 i përkasin gjinisë</p>		
--	--	--	--	--	--

				<p>femërore dhe 1928 i përkasin gjinisë mashkullore.</p> <p>17.Sa është numri i të rinjve (15-29 vjeç) përfitues të PAK për vitin 2023? Sa prej tyre janë femra dhe meshkuj? Numri total i të rinjve (15-29 vjeç) përfitues të PAK për vitin 2023 është 269. Nga këto 95 i përkasin gjinisë femërore dhe 174 i përkasin gjinisë mashkullore.</p> <p>18.Sa është numri total i personave të cilët janë pjesë e shërbimeve të kujdesit shoqëror për vitin 2023? Sa prej tyre janë femra dhe meshkuj? Numri total i personave që janë pjesë e shërbimeve të kujdesit shoqëror për vitin 2023 janë 7022 persona. Nga këto 350 i përkasin gjinisë femërore dhe 6672 i përkasin gjinisë mashkullore.</p> <p>19.Sa është numri i të rinjve (15-29 vjeç) përfitues të shërbimeve të kujdesit shoqëror për vitin 2023? Sa prej tyre janë femra dhe meshkuj? Numri total i të rinjve (15-29 vjeç) përfitues të shërbimeve të kujdesit shoqëror për vitin 2023 janë 300 persona. Nga këto 140 i përkasin gjinisë femërore dhe 160 i përkasin gjinisë mashkullore.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

21.	10.06.2024	Kërkesë për tu pajisur me një kopje të Urdhërit të Punës nr.9, datë 08.01.2024 të hartuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Korçë.	19.06.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, po ju vendosim në dispozicion bashkëngjitur një kopje të urdhërit Nr.9 datë 08.01.2024 të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore.	E plotë	S'ka tarifë																																				
22.	05.07.2024	<p>Kërkesë për t'u pajisur me informacion si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Sa ndërtesa e kanë të implementuar rampën në qytetin tuaj? 2. Sa institucione në qytetin tuaj e kanë të implementuar rampën? 3. Sa institucione në qytetin tuaj e kanë të implementuar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar? 4. Sa semaforë për të verbërit ka në qytetin tuaj? 5. Sa rrugë me sinjalistikën e posaçme për të verbërit që ndihet nga shkopat për të verbërit ka në qytetin tuaj? 6. A kanë mjetet e transportit publik akses për personat me aftësi të kufizuar? 7. Sa nga automjetet e transportit publik në bashkinë tuaj e kanë të implementuar rampën për njerëzit me aftësi të kufizuar? 8. Sa persona në total janë të punësuar në bashkinë e qytetit 	06.09.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 05.07.2024, sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës dhe Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, ju bëjmë me dije se:</p> <p>1-2-3. Objekte publike që ndodhen në të gjitha njësitë administrative të qytetit të Korçës të cilat janë të aksesueshme nga persona PAK janë:</p> <table border="1" data-bbox="1146 863 1629 1295"> <thead> <tr> <th>NR</th> <th>OBJEKTE SHTETERORE</th> <th>AKSES ME RAMPE *</th> <th>OBJEKTE NE TOTAL</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>NDËRTESA ADMINISTRATIVE</td> <td>14</td> <td>38</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>QËNDRA SHËNDETËSORE</td> <td>33</td> <td>57</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>NDËRTESA ARSIMORE</td> <td>14</td> <td>56</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Kopshte , Çerdhe</td> <td>4</td> <td>14</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Shkolla</td> <td>10</td> <td>42</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>NDËRTESA SOCIAL-KULTURORE</td> <td>6</td> <td>19</td> </tr> <tr> <td>5</td> <td>NDËRTESA SPORTIVE</td> <td>2</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td></td> <td>TOTAL</td> <td>69</td> <td>128</td> </tr> </tbody> </table> <p>Objektet janë të aksesueshme nëpërmjet rampave ose hyrja e tyre bëhet menjëherë</p>	NR	OBJEKTE SHTETERORE	AKSES ME RAMPE *	OBJEKTE NE TOTAL	1	NDËRTESA ADMINISTRATIVE	14	38	2	QËNDRA SHËNDETËSORE	33	57	3	NDËRTESA ARSIMORE	14	56		Kopshte , Çerdhe	4	14		Shkolla	10	42	4	NDËRTESA SOCIAL-KULTURORE	6	19	5	NDËRTESA SPORTIVE	2	5		TOTAL	69	128	E plotë	S'ka tarifë
NR	OBJEKTE SHTETERORE	AKSES ME RAMPE *	OBJEKTE NE TOTAL																																							
1	NDËRTESA ADMINISTRATIVE	14	38																																							
2	QËNDRA SHËNDETËSORE	33	57																																							
3	NDËRTESA ARSIMORE	14	56																																							
	Kopshte , Çerdhe	4	14																																							
	Shkolla	10	42																																							
4	NDËRTESA SOCIAL-KULTURORE	6	19																																							
5	NDËRTESA SPORTIVE	2	5																																							
	TOTAL	69	128																																							

		<p>tuaj? Dhe sa prej tyre janë me aftësi të kufizuar?</p> <p>9. Sa persona në total janë të punësuar në secilin institucionet që ju keni në varësi? Dhe sa prej tyre janë me aftësi të kufizuar?</p>		<p>në katin përdhe pa shkallë siç janë disa Qendra Shëndetësore në njësitë administrative.</p> <p>Objekte që janë të pajisura me ashensor janë 4. Objekte që janë të pajisura me tualet për PAK rezultojnë 2.</p> <p>4-5-6-7. Në qytet nuk ka semafor për të verbërit dhe as rrugë me sinjalistikë të posaçme për ta. Mjetet e transportit publik nuk kanë akses për personat me aftësi të kufizuara.</p> <p>8. Deri në muajin Korrik 2024, në Bashkinë Korçë janë të punësuar 291 persona, prej tyre nuk ka me aftësi të kufizuar.</p> <p>9. Numri i personave të punësuar në institucionet e varësisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndërmarrja e Shërbimeve Publike - 398, prej të cilëve 1 me aftësi të kufizuar; (Gusht 2024) - Qendra e Artit dhe Kulturës- 47 persona; (Gusht 2024) - Klubi Shumësportësh- 15 persona; (Gusht 2024) - NSHMAÇ- 386 persona, prej të cilëve 1 me aftësi të kufizuar. (Gusht 2024) 		
--	--	--	--	--	--	--

23.	10.07.2024	<p>Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Në çfarë faze janë punimet për aeroportin turisiko-sportiv në Korçë? 2. Sa është kostoja totale e financimit të këtij aeroporti? 3. çfarë punime janë kryer dhe çfarë kanë ngelur pa bërë për të përfunduar aeroporti turistik-sportiv në Korçë? 4. Kur pritet të përfundojë projekti? 5. Pse nuk ka është finalizuar ende aeroporti në Korçë? 6. Kush e financon këtë projekt? 7. Cilat janë arsyet e vonesave të këtij projekti brenda afateve të bëra publike? 	28.08.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion ju bëjmë me dije se:</p> <p>Në lidhje me punimet që po kryhen për aeroportin turistik dhe sportiv Bashkia Korçë ka miratuar lejen e ndërtimit me vendim Nr.4046/23, datë 30.06.2023, për objektin : Dua të luaj - Ndërhyrje për përmirësimin e hapësirave publike të destinuara për aktivitete rekreative dhe sportive - Korçë, me Zhvillues: Fondi Shqiptar i Zhvillimit.</p> <p>Për informacionin mbi fazën e punimeve, kostot, afatet etj, mund t'i drejtoheni Fondit Shqiptar të Zhvillimit.</p>	E plotë	S'ka tarifë
24.	10.07.2024	<p>Kërkesë për t'u pajisur me informacion për:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të më vendoset në dispozicion Planin i Veprimit për Eficiencën e Energjisë, në bashkinë tuaj. 2- Cilat janë hapat e ndërmarrë për zbatimin e këtij plani (buxheti në dispozicion, aktivitete, politika, etj.) 3- Nëse ky dokument nuk është hartuar ende, cilat janë arsyet? 4- Çfarë hapash parashikohet të ndërmerren në të ardhmen për zbatimin/hartimin e Planit të 	15.07.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 10.07.2024, ju bëjmë me dije se:</p> <p>Link-u ku gjendet i publikuar Planin Vendor i Veprimit për Energjinë dhe Klimën-</p> <p>https://bashkiakorçe.gov.al/files4users/files/MECAP_KORCA_2024-04-10.en.sq%281%29.pdf</p> <p>Planin Vendor i Veprimit për Energjinë dhe Klimën (MECAP) u përgatit në bashkëpunim mes Bashkisë Korçë dhe Projektit të Bashkive të Energjisë Smart (SEMP).</p>	E plotë	S'ka tarifë

		<p>Veprimet për Eficiencën e Energjisë?</p>	<p>Ky plan është hartuar, por nuk është miratuar, sepse jemi duke ndjekur hapat ligjorë si më poshtë:</p> <p>Bazuar ne nenin 124/2015 i ndryshuar, Neni 9/1</p> <p>1- Bashkitë përgatisin planet vendore të veprimeve për efikasitet të energjisë në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimeve për Eficiencën e Energjisë dhe me Planin e Integruar të Energjisë dhe Klimës, të cilat përfshijnë politikat dhe masat për përmirësimin e efikasitetit të energjisë për të gjithë sektorët që funksionojnë në nivel lokal, mbi bazën e konsumit të energjisë në nivel lokal. Kjo është realizuar nga Bashkia Korçë.</p> <p>2. Para miratimit nga këshilli bashkiak, projektplanet vendore të veprimeve për efikasitet të energjisë konsultohen me ministrinë dhe agjencinë përgjegjëse për energjinë, si dhe me përfaqësues të grupeve të interesit dhe përfaqësues të shoqërisë civile, për vlerësimin e përputhshmërisë së tij me politikat kombëtare të efikasitetit të energjisë dhe objektivat përkatës.</p> <p>Nga ana e MIE dhe AEE me shkresë 273/1 protokollin , datë 26.06.2024 është dërguar miratimi i këtij plani, duke vlerësuar përputhshmërinë e MECAP me politikat dhe objektivat kombëtare,.</p>		
--	--	---	--	--	--

			<p>Nga Bashkia Korçë do të realizohet konsultimi publik me aktorët lokalë dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile në datën 16.07.2024, ora 17:00 dhe 19:00 në sallën e këshillit bashkiak.</p> <p>3. Pas përfundimit të procesit të konsultimit me këto palë të interesuara, Këshilli Bashkiak miraton MECAP-in, i cili shënon fillimin e zbatimit dhe monitorimit të tij.</p> <p>Hapat që parashikohen të ndërmerren në të ardhmen për zbatimin e Planit të Veprimit për Energjinë dhe klimën Plani Vendor i Veprimit për Energjinë dhe Klimën (MECAP) është një strategji gjithëpërfshirëse, e zhvilluar nga administrata e bashkisë, për të përmirësuar menaxhimin e energjisë në mënyrë të qëndrueshme dhe për të ndihmuar në zbutjen e ndikimeve të ndryshimeve klimatike në juridiksionin e saj.</p> <p>Është një risi që Bashkia Korçë është një ndër bashkitë e para në nivel kombëtar që realizon një Plan Veprimi jo vetëm për energjinë por edhe për klimën MECAP përfshin kornizën kohore nga 2023 deri në 2040 dhe do të rishikohet çdo 5 vjet. Ai tregon kontributin e bashkisë në objektivat kombëtare për kursimin e energjisë, zgjerimin e</p>		
--	--	--	--	--	--

				<p>energjisë së rinovueshme të pastër dhe reduktimin e emetimeve të gazeve serrë. Në përputhje me Ligjin për Eficiencën e Energjisë nr 124/2015 i ndryshuar VKM nr. 872 dt. 29.12.2021 “Për miratimin e planit kombëtar për energjinë dhe klimën 2020-2023” është hartuar ky MECAP i cili përmban politika dhe masa për të arritur objektivat kombëtare në të gjithë sektorët në nivel bashkiak:</p> <p>I) Sektorët e drejtpërdrejtë:</p> <ol style="list-style-type: none">1) objektet publike bashkiake;2) ndriçimi publik rrugor;3) furnizimi me ujë dhe trajtimi i ujërave të zeza;4) flota bashkiake & transporti publik;5) menaxhimi i mbeturinave;6) të gjitha shërbimet tjera komunale. <p>II) Sektorët indirekt:</p> <ol style="list-style-type: none">1) sektori rezidencial;2) industria; shërbim privat/komercial;3) industria;4) makinat private & transport mallrash;5) bujqësia6) sektorë të tjerë brenda kufijve të bashkisë. <p>Deri në vitin 2030, Korça parashikon të bëjë përparim thelbësor drejt një</p>		
--	--	--	--	--	--	--

			<p>-menaxhimi më të qëndrueshëm të energjisë, -një gjurmë të reduktuar të karbonit dhe -rritje të elasticitetit të klimës. Bashkia është e përkushtuar të ndërmarrë hapa që integrojnë veprime të ndryshme që synojnë arritjen e një tranzicioni të gjelbër mesatarisht të drejtë dhe gjithëpërfshirës në shërbimet e saj publike.</p> <p>Ky tranzicion do të rezultojë në</p> <ul style="list-style-type: none"> - investime të gjelbra, -mundësi të reja punësimi, rritje -përmirësime në shëndetësi dhe arsim, -përmirësim të mirëqenies së përgjithshme, duke kontribuar në një mjedis më të shëndetshëm për popullatën. <p>Objektivat e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (NECP) të Shqipërisë për periudhën deri në vitin 2030 përfshijnë një ulje prej 18.7% të emetimeve të gazeve serrë, një ulje prej 8.4% në konsumin final të energjisë dhe një rritje prej 54.4% të energjisë së rinovueshme në përzierjen e energjisë, e cila është në përputhje me objektivat e anëtarësimit në BE.</p> <p>Edhe pse popullsia e Bashkisë së Korçës përfaqëson vetëm 4.6 % të popullsisë shqiptare, kontributi i saj në objektivat</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>kombëtare të reduktimit 2030 do të jetë rreth 2.44 %.</p> <p>Bazuar në analizat dhe prioritizimet gjithëpërfshirëse, janë identifikuar gjithsej 87 masa për t'u zbatuar në Bashkinë Korçë gjatë periudhës 2023-2040. Lista përfshin masat që janë tashmë në progres ose të planifikuara, dhe masa shtesë që duhet të ndërmerren (Skenari aktiv). Në listë përfshihen edhe masat për të cilat Bashkia e Korçës nuk është drejtpërdrejt përgjegjëse, por që lidhen me programet kombëtare ekzistuese apo masat e organizatave të tjera.</p> <p>Masat e propozuar janë 87 dhe përfshijnë kryesisht dhe jo vetëm:</p> <ul style="list-style-type: none">- Rinovimi energjetik i ndërtesave Publike- Rinovimi i ndriçimit publik.- Sektori rezidencial- Industria e shërbimeve dhe sektorët e bujqësisë- Ndërtesa të tjera Publike qendrore- Furnizimi me energji- Furnizimi me ujë dhe ujrat e përdorura- Menaxhimi i mbetjeve- Transporti publik- Transporti privat- Transporti i pa motorizuar- Komunikimi/ndërgjegjësimi. <p>Bashkia Korçë është përgjegjëse direkt për ndërtesat publike bashkiake,</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>ndriçimin rrugor, transportin publik, menaxhimin e mbetjeve, furnizimin me ujë të pijshëm dhe të ndotur, dhe indirekt për banesat, shërbimet, industrinë, bujqësinë, transportin privat dhe sektorë të tjerë.</p> <p>Buxheti i planifikuar për masat e propozuara është në vlerën prej 173.7 milionë euro (20.1 miliardë lekë), dhe vetëm 7 % do të mbulohet nga bashkia për shërbimet bashkiake, të tjerat do të mbulohen nga subjektet private. Këto investime që do të realizohen nga bashkia, kanë një periudhë vetëshlyerje investimesh (siç tregohet në plan), nga 2 – 7 vjet, me leverdi financiare për bashkinë, gjithashtu duke sjellë një rritje të ndjeshme të cilësisë së shërbimeve dhe komoditetit në çerdhe, kopshte, shkolla, transport, etj.</p> <p>Kjo është një përmbledhje e shkurtër e asaj çfarë përfaqëson ky plan.</p> <p>Datë 16.07.2024, ora 17:00 dhe 19:00, tek Salla e Këshillit Bashkiak, Bashkia Korçë do të zhvillohet një konsultim publik për Miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Energjinë dhe Klimën 2023-2040. Nëse jeni e interesuar mund të merrni pjesë.</p>	
--	--	--	---	--

25.	15.07.2024	<p>Kërkesë për informacion mbi pyllëzimet e kryera nga subjektet që operojnë në energjine hidrike HEC në territorin e bashkisë suaj nga viti 2008 e deri më sot.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Sa sipërfaqe janë pyllëzuar? 2. Në cilat parcela dhe ekonomi pyjore është bërë investimi? 3. A ka patur investime të tjera përveç pyllëzimeve? Nëse po, ku dhe çfarë investimi? 	29.07.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion date 15.07.2024, sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave ju bëjmë me dije se: Nga subjektet që operojnë në energjinë Hidrike nga viti 2016 deri më sot Kompania HEC TRESKA ka pyllëzuar 5 ha në ekonominë pyjore Ballabanovë në ngastrat 2a dhe 2b. Investime të tjera nuk ka patur. Para vitit 2016 nuk kemi informacion.</p>	E plotë	S'ka tarifë
26.	02.08.2024	<p>Kërkesë për informacion mbi ujërat e ndotura në fshatin Melcan, resortin dimeror SKIPISTA, aeroporti turistik dhe sportiv në Korçë si edhe për rrugën Lekas-Voskopojë dhe Voskopojë Krushovë.</p>	28.08.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 02.08.2024, ju bëjmë me dije se: Mini impianti në fshatin Melçan është i ndërtuar dhe funksional. (informacion nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.A) Në lidhje me punimet që po kryhen për aeroportin turistik dhe sportiv Bashkia Korçë ka miratuar lejen e ndërtimit me vendim Nr.4046/23, datë 30.06.2023, për objektin : Dua të luaj – Ndërhyrje për përmirësimin e hapësirave publike të destinuara për aktivitete rekreative dhe sportive – Korçë, me Zhvillues: Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Në lidhje me informacionin mbi fazën e punimeve, kostot, afatet etj, mund t'i drejtoheni Fondit Shqiptar të Zhvillimit. (informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit</p>	E plotë	S'ka tarifë

				<p>dhe Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës)</p> <p>Sipas të dhënave të marra nga Njësia Administrative Lekas dhe Voskopojë, Rruga Lekas-Voskopojë ka përfunduar me rehabilitimin e saj. Kjo rrugë është e gjatë 19 km dhe punimet po kryhen nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, nuk është investim por mirëmbajtje dhe sistemim i rrugës me çakull në pjesët e dëmtuara të saj. Sa i takon rrugës Krushovë-Voskopojë punimet për rehabilitimin e rrugës kanë përfunduar. Kjo rrugë është e gjatë rreth 7 km dhe punimet janë kryer nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike. Këto punime janë kryer vetëm në pjesët e dëmtuara të rrugës.</p>		
27.	06.09.2024	<p>Kërkesë për t'u pajisur me informacion:</p> <p>1. Sa hidrocentrale operojnë brenda territorit të Bashkisë Korçë?</p> <p>2. Sa kontrata për dhënien në përdorim të Fondit Pyjor ka lidhur Bashkia Korçë me këto subjekte?</p> <p>3. Për sa nga këto subjekte janë hartuar raportet për heqjen nga Fondi Pyjor?</p> <p>Kerkesa 2, me Nr. 164 Prot:</p>	20.09.2024	<p>Në përgjigje të kërkesave për informacion të depozituara nga ana juaj në datë 06.09.2024, sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave ju bëjmë me dije se:</p> <p>3. Sa Hidrocentrale operojnë brenda territorit të Bashkisë Korçë?</p> <p>Në territorin e bashkisë Korçë operojnë rreth 14 HEC-e.</p> <p>2. Sa kontrata për dhënien në përdorim të fondit pyjor ka lidhur Bashkia Korçë me këto subjekte?</p> <p>Bashkia Korçë sipas legjislacionit në fuqi për të gjitha HEC-et që janë ndërtuar gjatë periudhës që pyjet kanë qenë në</p>	E plotë	S'ka tarifë

		<p>1. Sa aktivitete minerare shfrytëzimi operojnë në territorin e Bashkisë Korçë?</p> <p>2. Çfarë numër kanë lejet e tyre? Na vendosni në dispozicion kopjet e tyre.</p> <p>3. Sa janë të ardhurat e gjeneruara nga këto aktivitete?</p>		<p>pronësi të bashkisë ka lidhur kontratë qiraje për dhënien në përdorim. Aktualisht ka 4 kontrata aktive.</p> <p>3. Për sa nga këto subjekte janë hartuar raportet për heqjen nga fondi pyjor? Raportet për heqjen nga fondi pyjor janë hartuar për të gjithë subjektet që bëjnë pjesë në fondin pyjor dhe janë dërguar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.</p> <p>Përsa i përket kërkesës tuaj Nr.164 prot ju bëjmë me dije se:</p> <p>3. Sa aktivitete minerare shfrytëzimi operojnë në territorin e bashkisë Korçë?</p> <p>Në territorin e bashkisë Korçë operojnë 6 subjekte (Gurore).</p> <p>2. Çfarë numër kanë lejet e tyre? Na vendosni në dispozicion kopjet e tyre? Subjektet që shfrytëzojnë janë ADEL shpk, TANUSHA shpk, AGBE DEKORACION shpk, ERA MERMER shpk, A.N.K shpk dhe 2D shpk. Në lidhje me nr e lejës minerare ju lutemi t'i drejtoheni AKBN-së.</p> <p>3. Sa janë të ardhurat e gjeneruara nga këto aktivitete?</p> <p>Të ardhurat e gjeneruara nga këto aktivitete janë në vlerën 2.074.947 lekë në vit.</p>		
--	--	--	--	---	--	--

28.	16.09.2024	<p>Kërkesë për t'u pajisur me informacion: Sa fonde keni marr/shpërndarë për minoritetin Rom & Egjiptian? Kush janë investimet që janë kryer gjatë 3 viteve të fundit nga Bashkia juaj për Romët & Egjiptianët? Nëse janë kryer, sa kanë kushtuar? Nëse ka pasur tender për këto investime, kush ka qënë fituesi i këtyre tenderave? Nga kanë ardhur fondet për këto investime? A kanë marrë fëmijët e minoriteti Rom & Egjiptian bursa nga bashkia juaj?</p> <p>Sa fëmij kanë përfituar, dhe në çfarë klase, çfarë zone dhe nga cila shkollë janë ato fëmijë?</p>	20.09.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 16.09.2024, sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Kujdesit Social dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes ju bëjmë me dije se:</p> <p>Pranë Drejtorisë së Kujdesit Social është e punësuar një Specialiste për Komunitetin Rom dhe Egjiptian që identifikon dhe adreson problematikat e këtij komuniteti. Bashkia Korçë çdo vit nëpërmjet Drejtorisë së Kujdesit Social zbaton një sërë projektesh të ndryshme.</p> <p>Nuk ka një buxhet të veçuar për minoritetet Rome dhe Egjiptiane, por të gjitha projektet që zbatohen kanë qëllim të mbështesin të gjitha grupet vulnerabël përfshirë këtu edhe minoritetet Rome dhe Egjiptiane.</p> <p>Më poshtë po ju informojmë për disa nga projekte: Kite shkolle për fëmijët nga familje në nevojë. Në këtë projekt mbështeten 100 fëmijë dhe një numër i konsiderueshëm i përkasin komunitetit Rom dhe Egjiptian. Këta fëmijë mbështeten me çanta shkolle, mjete didaktike për t'u ndjerë të gjithë të barabartë në procesin mësimor. Bashkia Korçë çdo vit organizon Kampin Veror Miqësia me synim gjithpërfshirjen</p>	E plotë	S'ka tarifë
-----	------------	---	------------	--	---------	-------------

			<p>e të gjithë fëmijëve, pa dallim, përfshirë këtu fëmijët me Aftësi të Kufizuara, fëmijët nga komuniteti Rom dhe Egjiptian, fëmijët nga mazhoranca në të gjitha aktivitetet.</p> <p>Çdo vit Bashkia Korçë mbështet familjet në nevojë duke i përjashtuar nga tarifa e kopshtit ose çerdhes. Nga të dhënat mbi 50% i përkasin fëmijëve të minoriteteve Rome dhe Egjiptiane.</p> <p>Gjithashtu prej shumë vitesh Bashkia Korçë ka ngritur tre qendra ditore për fëmijët romë dhe egjiptianë. Në këto qendra ofrohet nje vakt i ngrohtë ushqimor, fëmijët asistohen nga mësueset për realizimin e detyrave të shkollës, realizohen aktivitete edukuese, argëtuese për ta dhe prindërit e tyre. Numri i fëmijëve që frekuentojnë këto qendra është rreth 100 fëmijë.</p> <p>Këto tre qendra janë të pozicionuara në zona të ndryshme të qytetit me qëllim që shërbimi të jetë sa më afër fëmijëve dhe familjeve.</p> <p>Bashkia Korçë prej shumë vitesh organizon dhe zbaton projektet të dedikuara për minoritetet Rome dhe Egjiptiane si: 8 Prilli Dita Ndërkombëtare e Romëve dhe 24 Qershori Dita Ndërkombëtare e</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>Egjiptianëve. Këto aktivitete kanë si qëllim promovimin e kulturës dhe traditave të këtyre minoriteteve.</p> <p>Gjatë tre vjeçarit të fundit me mbështetjen e ROMACTED dhe organizatës "Gruaja në Zhvillim" Korçë është implementuar projekti “ To Make the Change” me një buxhet me vlerën prej 10,000 Euro. Nëpërmjet këtij projekti janë trajnuar 15 të rinj nga komuniteti rom/egjiptian për Social Media.</p> <p>Janë realizuar takime për nënat që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian duke trajtuar temat e punësimit, shëndetësisë, etj si dhe janë realizuar disa trajnime për orientimin e të rinjve drejt kurseve profesionale.</p> <p>Gjithashtu është realizuar panairi në zonën këmbësore të qytetit në datën 8 Prill, ku përfaqësues të këtij komuniteti kanë promovuar kulturën e tyre nëpërmjet punimeve artizanale si dhe është realizuar një koncert me këngë të ndryshme në kuadër të promovimit të kulturës së tyre.</p> <p>Për vitin shkollor 2023-2024 janë dhënë 498 bursa për shkollat 9-vjeçare dhe gjimnaze (Arsimi parauniversitar), ku</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>350 bursa janë mbështetur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe 148 bursa nga të Ardhurat e Bashkisë Korçë.</p> <p>Për shkollat profesionale janë dhënë 521 bursa që mbështeten nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.</p> <p>Fondi për bursa nga Ministria e Arsimit dhe Sportit: 23.924.250 lekë.</p> <p>Fondi për bursa nga të Ardhurat e Bashkisë Korçë që u vunë në dispozicion: 7.850.000 lekë.</p> <p>Në Arsimin 9 vjeçar: 64 % i përkasin pakicës romë/egjiptiane që u trajtuan me bursë, në Gjimnaze: 9% i përkasin pakicës romë/egjiptiane dhe në Arsimin Profesional: 19% i përket pakicës romë/egjiptiane.</p> <p>Gjithashtu i është vendosur në dispozicion edhe një listë me numrin e nxenesve që perfitojne burse sipas institucionet arsimore, sa prej tyre i perkasin pakices romes/egjiptiane.</p>		
29.	19.09.2024	<p>Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Per studentet , familjet e te cileve marrin ndihme ekonomike. 2. Bashkeshortet te cilet kane 2 apo me shume femije , perfitojne bursa financiare ? 3. Studente me aftesi te kufizuar , te vertetuar nga KMCAP qe jane perfities te Burses ? 	20.09.2024	<p>Në lidhje me kërkesën tuaj për informacion mbi bursat e studentëve ju bëjmë me dije se Bashkia Korçë nuk është institucioni kompetent për dhënien e informacionit. Ju duhet t'i drejtoheni Universitetit "Fan S. Noli" Korçë, në adresën e email: rektorati@yahoo.com.</p>	E deleguar	S'ka tarifë

		<p>4. Studentet te cilet kane te dy prinderit me aftesi te kufizuara , te vertetuar nga KMCAP .</p> <p>5. Studente te cilet jane jetim vetem nga njeri prind .</p> <p>6. Studente te cilet jane me stasin jetim qe nuk kane te dy prinderit .</p> <p>Sa eshte vlere e Burses qe keta studente perfitojne ne baze te statusi .</p> <p>Ne Qytetin tuaj sa studente jane qe perfitojne Bursa ?</p> <p>A ka kapacitet Bashkia ti mbuloje te gjithë studentet te cilet ju takon Bursa ?</p> <p>Periudha e Aplikimit per ta perfituar .</p>				
30.	22.10.2024	<p>Kërkesë për t'u pajisur me informacion:</p> <p>1. A ka bashkia nje Plan Social te miratuar dhe nese po kur eshte miratuar?</p> <p>2. A ka aplikuar Bashkia Tirane per te perfituar nga Fondi Social dhe a jeni shpallur fitues ne vitin 2024?</p> <p>3. Sa ka qene vlere totale e miratuar nga MSHMS per vitin 2024 dhe per cilat kategori sherbimesh do te perdoren?</p>	28.10.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 23.10.2024, po ju vendosim në dispozicion të dhënat e marra nga Drejtoria e Kujdesit Social:</p> <p>1. A ka bashkia një Plan Social të miratuar dhe nëse po kur është miratuar? Bashkia Korçë ka hartuar dhe miratuar Planin Social 2024-2027 në Dhjetor të vitit 2023.</p> <p>2. A ka aplikuar Bashkia Korçë për të përfituar nga Fondi Social dhe a jeni shpallur fitues në vitin 2024? Bashkia Korçë ka aplikuar dhe ka dalë fituese e Fondit Social në vitin 2021-</p>	E plotë	S'ka tarifë

		<p>4. A është disbursuar në masën 100% fondi i kushtëzuar i MSHMS për vitin 2024?</p> <p>5. A keni përthithur fonde nga Fondi Social për vitin 2023, në çfarë vlerë ka qenë fondi i përfituar dhe për cilat kategori shërbimesh janë përdorur?</p> <p>6. Sa përqind të fondit të përfituar keni përdorur deri tani të ndarë sipas viteve, 2023 dhe 2024?</p> <p>7. A keni parashikuar në buxhetin afatmesëm 2025-2027 ngritje të fondeve për të mbajtur në funksion shërbimet e ofruara në territor edhe pas përfundimit të financimit të Fondit Social?</p> <p>8. Cilat janë kategoritë e shtesave vulnerabel të identifikuar në bashkinë tuaj që mund të përfitojnë nga shërbimet sociale?</p>		<p>2023 për ngritjen dhe funksionimin e “Qendrës së Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijët dhe Familjen me bazë komunitare” në zbatim të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit për transformimin e shërbimeve rezidenciale në shërbime me bazë komunitare.</p> <p>3. Sa ka qenë vlera totale e miratuar nga MSHMS për vitin 2024 dhe për cilat kategori shërbimesh do të përdoren? Bashkia Korçë ka kërkuar mbështetje MSHMS për vazhdimin e financimit pas përfundimit të afatit 36 muaj në vlerën 30% nga Fondi Social si parashikohet në VKM Nr. 150/ 2019 pika 29 për mundësinë e vazhdimësisë për Qendrën e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijët dhe Familjen me bazë komunitare.</p> <p>4. A është disbursuar në masën 100% fondi i kushtëzuar i MSHMS për vitin 2024? Fondi i kushtëzuar i MSHMS është disbursuar në masën 100%.</p> <p>5. A keni përthithur fonde nga Fondi Social për vitin 2023, në çfarë vlerë ka qenë fondi i përfituar dhe për cilat kategori shërbimesh janë përdorur? Viti 2023 përkon me vitin e 3- të të Fondit Social dhe vlera e financimit ka qenë 30% dhe vlera në lek 3,946,724.00. Kategoritë e shërbimeve për të cilat janë përdorur fondet janë: mbështetje direkte për raste emergjente (paketa ushqimore,</p>		
--	--	--	--	---	--	--

				<p>paketa higjeno-sanitare dhe veshmbathje), mjete kancelarie për punën me fëmijët dhe të rritur dhe paga e tre personave të stafit.</p> <p>6. Sa përqind të fondit të perfituar keni përdorur deri tani të ndare sipas viteve, 2023 dhe 2024? Në vitin 2023 është përdorur 70%. Në vitin 2024 deri në muajin shtator në masën 40%.</p> <p>7. A keni parashikuar në buxhetin afatmesëm 2025-2027 ngritje të fondeve për të mbajtur në funksion shërbimet e ofruara në territor edhe pas përfundimit të financimit të Fondit Social? Në zbatim të planit të deinstitutionalizimit dhe transformimit të shërbimeve rezidenciale në shërbime me bazë komunitare Bashkia Korçë është duke punuar me MSHMS për transformimin e shërbimit dhe kostimin e shërbimeve të reja ku përfshihet edhe shërbimi i ngritur nga financimi i Fondit Social.</p> <p>8. Cilat janë kategoritë e shtesave vulnerabel të identifikuar në bashkinë tuaj që mund të përfitojnë nga shërbimet sociale? Në specifikat që targetojnë përfituesit e shërbimeve pranë SHMFF mund të përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none">• familje që kanë fëmijë të vendosur në institucionet e përkujdesit shoqëror	
--	--	--	--	---	--

				<p>për fëmijë (pavarësisht arsyeve që kanë sjellë ndarjen e fëmijës);</p> <ul style="list-style-type: none"> • familje që janë në rrezik për institucionalizimin e fëmijëve të tyre; • familje me vështirësi të theksuara në ushtrimin e prindërimit që ndikojnë në zhvillimin e fëmijës dhe dinamikave familjare; • familje me marrëdhënie konfliktuale, duke përfshirë familje të divorcuara, me një prind, kryefamiljare nëna, nëna-vajza, apo në kushtet e një humbje të madhe në familje, etj; • familje me anëtarë me probleme të shëndetit mendor apo fizik, përdorimit dhe abuzimit me lëndë alkoolike/narkotike, aftësisë ndryshe; • familje kujdestare (profesionale) në nevojë për të përballuar përshtatjen me fëmijën apo menaxhimin e sjelljeve të tij/saj; • probleme të theksuara prindërimi që mund të ndikojnë dhe/ose në zhvillimin e fëmijës. • familje në vështirësi social-ekonomike. 		
31.	28.10.2024	<p>Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi:</p> <p>1. Sa është buxheti vjetor i bashkisë tuaj? Sa prej tij shpenzohet për projekte</p>	01.11.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 28.10.2024, sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Strehimit Social ju bëjmë me dije se:</p>	E plotë	S'ka tarifë

		<p>sociale? Ka ndodhur të mbeten fonde pa u shfrytëzuara? (Ju lutem të dhënat për 3 vitet e fundit)</p> <p>2. A keni aplikuar në institucionet qëndrore me projekte në thirrjet që hapen? Sa aplikime keni paraqitur? Sa herë bashkia juaj ka rezultuar fituese? Kur nuk rezultoni fitues, cilat janë arsytet që ju penalizojnë? (të dhënat në shifra 3 vitet e fundit)</p> <p>3. Cili është projekti i fundit që keni aplikuar? Si i hartoni projektet, a keni ekip pune të posaçëm, të trajnuar?</p> <p>4. Në zonën tuaj sa familje ka që trajtohen me ndihmë ekonomike? Sa familje kanë persona që trajtohen me kemp? Sa dhe si ju mund t'i mbështesë bashkia juaj këta persona?</p> <p>5. Sa familje janë të pastreha në bashkinë tuaj?</p>		<p>1. Sa është buxheti vjetor i bashkisë tuaj? Sa prej tij shpenzohet për projekte sociale? Ka ndodhur të mbeten fonde pa u shfrytëzuara? (Ju lutem të dhënat për 3 vitet e fundit)</p> <p>Bashkia Korçë nëpërmjet Drejtorisë së Kujdesit Social zbaton një sërë projektesh të ndryshme me qëllim gjithëpërfshirjen. Disa nga projektet që implementon dhe zbaton Drejtoria e Kujdesit Social janë: “Kampi Veror, Miqësia”, “Fond Social për rastet emergjente”, “ Qendra Ditore për Fëmijë-Fuqizimi i Fëmijëve Romë dhe Egjiptianë”, ”20 Nëntori, Dita e të Drejtave të Fëmijëve”, ”Kite shkollore për fëmijët në nevojë”, “Strehëza Emergjente”, “25 Nëntori - Ndërgjegjësimi i komunitetit në zonat rurale nëpërmjet aktiviteteve sensibilizuese në luftën kundër dhunës në familj.”,“Dita Ndërkombëtare e Komunitetit Rom” ,“3 Dhjetori - Dita Botërore e Autizmit”, “Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara”, “Qendër Komunitare për Moshën e Tretë”, “Dita e Egjiptianëve të Ballkanit”.</p> <p>Nga buxheti i Bashkisë Korçë shpenzimet për projektet sociale që</p>		
--	--	---	--	---	--	--

			<p>implementon Drejtoria e Kujdesit Social janë si më poshtë:</p> <p>Viti 2021: 5,263,900 lekë</p> <p>Viti 2022: 5,760,000 lekë</p> <p>Viti 2023: 5,993,000 lekë</p> <p>2. A keni aplikuar në institucionet qëndrore me projekte në thirrjet që hapen? Sa aplikime keni paraqitur? Sa herë bashkia juaj ka rezultuar fituese? Kur nuk rezultoni fitues, cilat janë arsyet që ju penalizojnë? (të dhënat në shifra 3 vitet e fundit)</p> <p>Bashkia Korçë ka aplikuar në Fondin Social për projektin “Qendër Komunitare për Shërbimet Mbështetëse për Fëmijët dhe Familjen” në kuadër të Deinstitutionalizimit tek Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe aktualisht mbështetet nga Fondi Social me 30% çdo vit.</p> <p>Bashkia Korçë ka aplikuar pranë UNDP-së me projektin “Përfshirje Sociale për Ndryshim” dhe duke dalë fituese ka zbatuar projektin gjatë vitit 2023-2024. Gjithashtu, në shpalljen për aplikim nga ROMACTED Bashkia Korçë ka aplikuar me projektin “Për të Sjellë Ndryshimin”</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>dhe pasi ka dalë fituese ka zbatuar këtë projekt gjatë viti 2023 me në fokus komunitetin Rom dhe Egjiptian dhe me qëllim integrimin dhe gjithëpërfshirjen e këtij komuniteti.</p> <p>3. Cili është projekti i fundit që keni aplikuar? Si i hartoni projektet, a keni ekip pune të posaçëm, të trajnuar?</p> <p>Bashkia Korçë, së fundmi në bashkëpunim me organizatën “Nisma për Ndryshim Shoqëror "ARSIS” në kuadër të thirrjes EU4SocialInclusion ka aplikuar për ngritjen e një sistemi të integruar shërbimesh të kujdesit shoqëror me natyrë komunitare dhe është në fazën e pritjes së përgjigjes.</p> <p>Gjithashtu, Bashkia Korçë në bashkëpunim me organizatën “Nisma për Ndryshim Shoqëror “ARSIS” dhe Dorcas AID ka aplikuar në thirrjen e UNDP për EU4LMI dhe është në fazën e pritjes së përgjigjes.</p> <p>Pranë Bashkisë Korçë ka një zyrë për hartimin e projekteve dhe aplikimet bëhen me mbështetjen e kësaj zyre, por edhe nga bashkëpunimi me organizatat joqeveritare lokale dhe kombëtare.</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>Në përgjigje të çeljes së thirrjes për aplikime për projektet e investimit që do të financohen nga buxheti i shtetit në vitet 2024-2025, jemi fitues për vitin 2024 (për herë të 6 prej vitit 2019) të projektit "Investime në strehim, në programi i përmirësimit të banesave ekzistuese për familjet e varfëra dhe të pafavorizuara", me përfitues 19 familje, në bashkëfinancim me buxhetin e shtetit në kuotat 40% të kostos së projektit e financon buxheti i bashkisë Korçë dhe 60% buxheti i shtetit nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës, Inovacionit që mbulon çështjet e strehimit. Hartimi i projekteve bëhet nga grupi i punës me specialistë të fushës ngritur me urdhër të kryetarit të bashkisë si dhe nëpërmjet bashkëpunimit me sektorët e tjerë sipas përcaktimeve në termat e referencës.</p> <p>4. Në zonën tuaj sa familje ka që trajtohen me ndihmë ekonomike? Sa familje kanë persona që trajtohen me kemp? Sa dhe si ju mund t'i mbështesë bashkia juaj këta persona?</p> <p>Trajtimi me ndihmë ekonomike të çdo familje pa të ardhura ose të ardhura të pamjaftueshme bëhet nëpërmjet aplikimit në sistemin elektronik të Ndihmës Ekonomike, i cili nëpërmjet sistemit të</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>pikëzimit përcakton fituesit. Në Bashkinë e Korçës janë 740 familje që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe 5140 individë që trajtohen me pagesë paaftësie (personat me aftësi të kufizuara, invalidët e punës, të verbërit, para dhe tetraplegjik).</p> <p>Bashkia Korçë, nëpërmjet Drejtorisë së Kujdesit Social dhe bashkëpunimit me fondacionin FSHDPAK në bazë të kërkesave të personave paratetraplegjike ka mundësuar paisjen e tyre me karrige me rrota.</p> <p>Bashkia Korçë me aplikimin pranë UNDP, në kuadër të programit “ Askush të mos mbetet pas”, ka ngritur “Qendrën Komunitare për Fëmijët më Aftësi të Kufizuara” në të cilën ofrohen shërbime si: Terapi Zhvillimi, Logopedi, Fizioterapi. Përfitues të këtyre shërbimeve aktualisht janë 40 fëmijë me probleme të zhvillimit dhe aftësi të kufizuara që i përkasin grupmoshës 0-18 vjeç.</p> <p>Gjithashtu, pranë Bashkisë Korçë funksionon Qendra Ditore e Zhvillimit pranë të cilës marrin shërbim 18 persona me aftësi të kufizuar të grupmoshës 18 - 35 vjet. Vizioni i qendrës është ndihmesa nëpërmjet programeve riaftësuese,</p>	
--	--	--	--	--

			<p>aktiviteteve prodhuese me karakter shtëpiak, aktivitete argëtuese etj. me qëllim integrimin e PAK në jetën sociale.</p> <p>-Pranë Qendrës Rezidenciale të Zhvillimit për persona me aftësi të kufizuara Korçë, ofrohet shërbim rezidencial për persona me aftësi të kufizuara. Përfitues të shërbimeve pranë qendrës janë persona të moshës 0-21 vjeç. Qendra ofron asistencë psiko-sociale, programe psiko-edukative, kujdes shëndetësor si dhe programe zhvilluese për rritjen e aftësive për vetëkujdesje.</p> <p>5. Sa familje janë të pastreha në bashkinë tuaj?</p> <p>Si rezultat i vlerësimit të nevojave për strehim rezultojnë 1353 familje të pastreha në Bashkinë e Korçës, shifër që i referohet raportimit vjetor dhe progresiv ndër vite.</p> <p>Në zbatim të ligjit 22/2018 "Për Strehimin Social" tashmë numri i familjeve të pastreha merr kuptim me numrin e familjeve të regjistruara në sistemin on-line të strehimit social nëpërmjet portalit unik qeveritar e -</p>		
--	--	--	--	--	--

				Albania, për të përfituar nga programet sociale të strehimit dhe në kuptim të nenit 13 të ligjit "statusin e përfituesit nga programet sociale të strehimit e fiton cdo individ /familje që nuk ka banesë ,i cili/e cila banon në mjedise që nuk klasifikohen si vende për banim apo në një banesë të përkohshme, në kuptim të këtij ligji dhe nuk ka mundësi ekonomike e financiare për të siguruar një banesë". Kështu vetëm në vitin 2023 në sistemin on-line të strehimit janë regjistruar gjithsej 178 familje për të përfituar nga programet e strehimit, nga të cilat 112 familje janë trajtuar dhe janë përfitues nga programet e strehimit social, në vitin 2024 për periudhën janar-31 tetor, në sistemin on-line të strehimit janë regjistruar gjithsej 143 familje për të përfituar nga programet e strehimit, nga të cilat 85 familje janë trajtuar dhe janë përfitues nga programet e strehimit social që zbatohen në Bashkinë Korçë.		
32.	06.11.2024	Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi: 'Resorti dimeror -SKIPISTA' · Ne cfare faze ndodhet aktualisht premtimi per ndertimin e resortit dimeror SKIPISTA? · A ka gjetur Bashkia rrugen e financimit te ketij projekti?	12.11.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 06.11.2024, ju bëjmë me dije se: Projekti i ndërtimit të një piste skish në afërsi të qytetit të Korçës është një projekt i rëndësishëm për zhvillimin e sektorit të turizmit në bashkinë tonë dhe në gjithë rajonin e Korçës. Për shkak të madhësisë së projektit dhe vlerës së investimit, realizimi i tij do të kërkojë	E plotë	S'ka tarifë

		<ul style="list-style-type: none"> · Kur pritet te nis puna konkrete per kete projekt? · Ne cilin vend parashikohet te ndertohet resorti i skive? · Sa eshte vlere e investimit? · Sa kohe do te marre perfundimi i ketij projekti? 		<p>përfshirjen e aktorëve të ndryshëm si qeveria shqiptare, bashkia ose bashkitë e rajonit, federata shqiptare e skive si dhe investitorë privatë potencialë.</p> <p>Zbatimi i këtij projekti është i lidhur ngushtësisht edhe me situatën e klimës dhe prezencën e sasisë së përshtatshme të borës, në një kohëzgjatje të caktuar në sezonin e dimrit, në zonën ku do të zhvillohet projekti, e cila është parakusht për realizimin e këtij projekti dhe përcakton edhe afatet e zbatimit të tij.</p> <p>Aktualisht jemi duke monitoruar situatën e kushteve klimatike në një zonë në malin e Gramozit, nëpërmjet një stacioni meteo të instaluar atje.</p>		
33.	11.11.2024	<p>Kërkesë për t’u pajisur me informacion:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kush është financuesi i projektit që po zbatohet në Përroin e Lubonjës? 2. A është ky projekt i pajisur me leje mjedisore? Na vendosni në dispozicion një kopje të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM). 3. Sa është afati i punimeve? 4. Sa është vlere e investimit? 5. Na vendosni në dispozicion një kopje të këtij projekti. 	15.11.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj Nr.180 Prot, datë 11.11.2024, nëpërmjet të cilës keni shprehur kërkesën në lidhje me financuesin e Projektit që po zbatohet në Përroin e Lubonjës,afatin e punimeve,vlerën e investimit dhe projektin ju informojmë se :</p> <p>Bashkëlidhur shkresës 67are67 përcjellim Vendimin Nr. 307, datë 22.5.2024 “Për Miratimin E Projekteve Fituese Të Financuara Për Vitin 2024 Nga Fondi Për Parandalimin Dhe Menaxhimin E Fatkeqësive Natyrore, Si Dhe Të Autoritetit Kontraktor Për Zbatimin E Projekteve, Sipas Njësive Të Vetëqeverisjes Vendore” si dhe linkun i cili është i aksesueshëm nga çdo person i</p>	E plotë	S’ka tarifë

				<p>interesuar për të 68are procedurën e tenderimit, afatin, vlerën dhe projektin. Linku i Agjencisë së Prokurimit Publik për të aksesuar të dhënat e kërkuara nëpërmjet shkresës tuaj: https://www.app.gov.al/njoftimi-i-fituesit/.</p>		
34.	14.11.2024	<p>Kërkesë për t'u pajisur me informacion: Sipas Planit Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane publikuar nga bashkia juaj duke vendosur këto pika si qëllime për përmirsim në lidhje me:</p> <p>arsimin, shëndetsinë, strehimin, rregjistrimin në gjëndjen civile si dhe përfshirjen sociale,</p> <p>2- A janë arritur këto qëllime nga bashkia juaj?</p> <p>3- Nëse po, sa familje janë ndimuar?</p> <p>4- Sa familje Rome keni ju në bashkin tuaj ?</p> <p>5- Sa familje Egjiptiane keni ju në bashkin tuaj?</p> <p>6- Çfar problematikash kanë ata ne zonën ku këta familje banojnë?</p> <p>7- Nëse ka, a keni gjetur zgjidhje për këto problematika?</p>	21.11.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 14.11.2024, po ju vendosim në dispozicion informacionin e kërkuar:</p> <p>Plani Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane është një dokument shumë i rëndësishëm për Bashkinë Korçë si dhe një instrument i pazëvendësueshëm në rrugën e përfshirjes dhe integritit të pakicave në bashkinë tonë. Vlera e shtuar e tij qëndron në procesin dhe metodologjinë e ndjekur për hartimin e planit ku përqsja gjithëpërfshirëse, me pjesëmarrjen e vazhdueshme dhe në çdo hap të procesit të aktorëve përgjegjës dhe veçanërisht të aktivistëve, organizatave dhe qytetarëve romë dhe egjiptianë, pjesë e Grupit Komunitar të Veprimit, e bën këtë dokument një instrument të rëndësishëm zhvillimi, por dhe përgjigjshmërie të pushtetit vendor ndaj qytetarëve.</p>	E plotë	S'ka tarifë

				<p>Plani Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane, udhëhiqet nga disa parime themelore si:</p> <ul style="list-style-type: none">(i) nxitja e përfshirjes sociale,(ii) reagim ndaj situatave të vështira social-ekonomike dhe emergjente për pakicat rome dhe egjiptiane,(iii) respektimit të dallimeve midis pakicave rome dhe egjiptiane,(iv) përfshirjen e pakicave në identifikimin e nevojave dhe hartimin e masave,(v) forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit midis aktorëve: bashkisë dhe institucioneve qendrore, organizatave të shoqërisë civile, aktivistëve dhe grupeve komunitare. Në vijim paraqiten nevojat e vlerësuara dhe masat e parashikuara sipas fushave prioritare: arsimi, punësimi dhe siguria ekonomike, strehimi, shëndeti dhe çështje të tjera të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale e shanseve të barabarta. <p>Plani vendor përfshin projekte konkrete për integrimin e komunitetit rom dhe egjiptian në Korçë, një program i mbështetur nga Këshilli i Europës, për të qenë sa më afër nevojave të këtij komuniteti. Përveç vëmendjes në përmirësimin e kushteve të banimit të komunitetit rom, Bashkia Korçë është</p>	
--	--	--	--	---	--

			<p>angazhuar po ashtu edhe për integrimin e këtij komuniteti në jetën sociale.</p> <p>Objektivat strategjikë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i situatës arsimore të pakicave rome dhe egjiptiane në Bashkinë Korçë. • Fuqizimi ekonomik i pakicave rome dhe egjiptiane në Bashkinë Korçë, përmes integritit dhe harmonizimit të ndërhyjeve për kualifikime, punësim dhe programeve të mbrojtjes sociale. • Përmirësimi i gjendjes së strehimit të pakicave rome dhe egjiptiane në Bashkinë Korçë, përmes ndërhyrjeve të qëndrueshme. • Përmirësimi i shëndetit dhe aksesit në shërbimet shëndetësore për anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane në Bashkinë Korçë • Ri-integrimi i familjeve rome dhe egjiptiane të kthyer nga migrimi. • Fuqizimi i aktivizmit dhe përfaqësimit politik dhe atij në vendimmarrje të romëve dhe egjiptianëve në Bashkinë Korçë <p>Në Korçë është çelur Qendra Komunitare Ndërkulturore, një hapësirë e re e cila i krijon komunitetit rom mundësi që të kryejë një sërë aktivitete të tilla si: mbledhje, trajnime apo edhe aktivitete sportive. Kjo qendër është pjesë e planveprimit të programit për përfshirjen sociale të komunitetit rom. Ky program</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>financohet nga BE dhe implementohet nga UNDP në partneritet me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.</p> <ol style="list-style-type: none">1- Përmirësimi i gjendjes së strehimit të pakicave rome dhe egjiptiane në Bashkinë Korçë, përmes ndërhyrjeve nga Bashkia Korçë;2- Rehabilitimi dhe sistemimi i kanalizimeve në zonat me popullsi rome dhe egjiptiane (prioritare Ish-gjeologjika, Ndërtimi, Bujqësorja) nga Bashkia Korçë;3- Ndërgjegjësim për rëndësinë e lidhjes dhe pagesave të rregullta të kontratave të ujit të pijshëm dhe energjisë elektrike (veçanërisht në banesat kolektive të R&E). MEI/ OSHEE4- Kërkesë ndaj të kontaktuarve për pastrimin e qytetit për një vëmendje të shtuar në zonën e ish-konviktit të Ndërtimit si dhe angazhimi i 1-2 administratorëve nga ky komunitet për mundësimin e rezultateve të qëndrueshme në mirëmbajtjen e godinës dhe mjedisit përreth.5- Identifikimi i rasteve për formalizim (regjistrim) të banesave të ndërtuara në mënyrë jo-ligjore/të parregullt.6- Sigurimi i asistencës juridike për anëtarët e minoriteteve rome dhe egjiptiane që kanë probleme dokumentacioni/regjistrimi/ procesi gjyqësor.		
--	--	--	---	--	--

			<p>7- Vijimi i përcaktimit të kuotave (%) për romët dhe egjiptianët në përfitimin nga banesat sociale (përfshirë lehtësimin e procedurave/kushteve).</p> <p>8- Mbështetja e familjeve të pastreha me pagesa qiraje (duke filluar me familjet e ish-gjeologjikes) dhe vendosja e tyre në lista prioritare për skemat e punësimit.</p> <p>9- Forcimi i lidhjes midis OSHC-ve R&E, Bashkisë dhe aktorëve të tjerë vendore përmes aktiviteteve të përbashkëta.</p> <p>10- Ofrimi i intershipeve për pakicat rome dhe egjiptiane, Bashkia Korçë Qendra Komunitare Korçë OSHC-të Biznesi lokal.</p> <p>11- Fushata ndërgjegjësimi për aktivizmin dhe pjesëmarrjen politike/vendimmarrëse në komunitetet rome dhe egjiptiane.</p> <p>12- Punësimi i koordinatorit të Qendrës Komunitare, Qendra Komunitare Korçë, Bashkia Korçë.</p> <p>13- Fuqizimi ekonomik i minoriteteve rome dhe egjiptiane në Bashkinë Korçë, përmes integritit dhe harmonizimit të ndërhyjeve për kualifikime, punësim dhe programeve të mbrojtjes sociale.</p> <p>14- Përmirësimi i gjendjes së strehimit të minoriteteve rome dhe egjiptiane në Bashkinë Korçë, përmes ndërhyrjeve të</p>	
--	--	--	---	--

			<p>qëndrueshme, për vitet 2019,2020,2021,2022,2023,2024.</p> <p>15- Përmirësimi i shëndetit dhe aksesit në shërbimet shëndetësore për anëtarët e minoriteteve R&E në Bashkinë Korçë, për vitet 2019,2020,2021,2022,2023,2024.</p> <p>16- Ri-integrimi i familjeve romë dhe egjiptiane të kthyer nga migrimi, totali për vitet 2019,2020,2021,2022,2023,2024.</p> <p>Punësimi: Një nga sfidat tona në të ardhmen është edhe përfshirja e të rinjve në trajnime të ndryshme për aftësimin e tyre dhe punësimin. Prej disa vitesh të rinj nga komuniteti rom dhe egjiptian kanë qenë pjesë e praktikave mësimore dhe punësimit sezonal në institucionin e bashkisë.</p> <p>Pjesa dërmuese e romëve dhe egjiptianëve në Korçë (si edhe në vende të tjera) i sigurojnë të ardhura përmes vetëpunësimit me aktivitete të tilla si: tregëtimi në pazar i produkteve artizanale (si p.sh atyre prej thupre, një traditë e trashëguar e romëve), rrobave të përdorura; pastrimi i shtëpive; kryejnë punë sezonale (p.sh në bujqësi apo në emigracion); mbledhje dhe riciklim të materialeve të riciklueshme (plastikë, hekur etj).</p>		
--	--	--	--	--	--

				<p>Zyra e Formimit Profesional ofron kurse profesionale për romët dhe egjiptianët. Punësimi i koordinatorit të Qendrës Komunitare nga ana e Bashkisë Korçë. Regjistrimi në Gjendjen Civile: Zyra e Gjendjes Civile në bashkëpunim me Drejtorinë e Kujdesit Social dhe organizata të ndryshme ka mundësuar regjistrimin e fëmijëve nga familje të komunitetit rom dhe egjiptian të cilët kanë pasur probleme me dokumentacionin.</p> <p>Arsimi: Ka një ndërgjegjësim në rritje për rëndësinë e arsimit dhe problematikat që shoqërojnë mungesën/nivelin e ulët të tij ndër anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane. Rritja e frekuentimit dhe cilësisë së ndjekjes së arsimit (të paktën atij të detyrueshëm) është evidentuar si një nevojë urgjente për adresim gjatë rrugës për integrimin e pakicave rome dhe egjiptiane. Marrëdhënia me arsimin dhe edukimin duhet të nisë sa më herët për të qenë e qëndrueshme dhe për të mundësuar të ndërtohet gradualisht mbi themele të forta. Raportohet se rreth 115 fëmijë rom dhe egjiptianë janë të regjistruar në një kopësht apo parashkollor. Në arsimin e detyrueshëm raportohen të jenë të regjistruar rreth 1200 fëmijë romë dhe egjiptianë (6-15</p>	
--	--	--	--	---	--

			<p>vjeç). Braktisja e shkollës mbetet në nivele shqetësuese me të paktën 25 nxënës ose 7% të fëmijëve romë dhe egjiptianë, që e kanë braktisur shkollën. Edhe më shqetësuese janë arsyet e braktisjes, të cilat ndryshe nga pritshmëria se janë të lidhura kryesisht me gjendjen e rënduar ekonomike, rezultojnë të mbizotërohen më tepër nga ato kulturore, që më pas çojnë në një mbipërfaqësim të vajzave ndër fëmijët të cilët e braktisin shkollën duke iu drejtuar më pas edhe martesave të hershme. Edhe pse cilësia e infrastrukturës së shkollave ku mësojnë shumica e fëmijëve R&E është e ngjashme me ato nënzona të tjera të bashkisë, janë kushte shumë të mira, nevojat e identifikuar janë thelbësore për tërheqjen e fëmijëve R&E drejt shkollës dhe ndërtimit të një raporti pozitiv me shkollën.</p> <p>Strehimi: Ky komunitet është në nevojë për të përfituar nga programet e strehimit social. Ka pasur aplikime për të gjitha programet e strehimit, por kryesisht janë pretendente për projektin e përmirësimit të kushteve të banimit, banesat sociale me qira dhe subvencionin e qirasë. Për strehimin e komunitetit rom është zbatuar ligji ku ky komunitet të trajtohet me prioritet. Ka zbatuar programin e përmirësimit të kushteve të banimit, ku</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>përfitues janë kryesisht familje të ketij komuniteti. Përmendim se kanë qenë përfitues 11 banesa kolektive dhe 6 banesa individuale për vitin 2024. Ky projekt ka filluar zbatimin e tij që nga viti 2019 dhe çdo vit tek ky projekt kanë qënë të pëfshira dhe familje nga komuniteti R/E dhe ka pasur një impakt shumë të madh në komunitet, pasi kanë përfituar shumë familje. Tek subvencionit i qirasë gjithashtu kanë përfituar familje të komunitetit rom, tek banesat me qira sociale shumica e përfituesve kanë qenë familje nga komuniteti rom. Gjithashtu edhe tek të gjitha banesat të cilat janë shpërndarë nga ana e Bashkisë dhe Enti Kombëtar i Banesave Korçë ky komunitet ka qënë gjithmonë i trajtuar.</p> <p>Shëndeti: Vendbanimet me përqëndrim të pakicave R&E nuk janë larg qendrave shëndetësore dhe kushtet e tyre si në infrastrukturë dhe në personel janë të njëjta me pjesën tjetër të komunitetit, aksesit që romët dhe egjiptianët kanë në shërbimet e kujdesit shëndetësor është i njëjtë. Kështu, nga popullsia totale e raportuar për këto pakica, janë të regjistruar me një mjek familjeje. Gjithashtu, raportohet se kanë një kartë shëndeti. Marrëdhënia me tregun e punës dhe sigurimet shëndetësore është një nga pengesat</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>kryesore në rritjen e aksesit të kujdesit shëndetësor për këto pakica. Nga ana tjetër, mungesa e informacionit dhe gjendja e vështirë ekonomike e pjesës më të madhe të familjeve R&E ndikon gjithashtu në uljen e nivelit të aksesit që anëtarët e pakicave R&E kanë në kujdes shëndetësor. Hendeku midis kërkesës (nevojave) dhe ofertës (shërbimit dhe aksesit ndaj tij) bëhet edhe më i madh duke pasur në konsideratë që kushtet e vështira të jetesës për një pjesë të komuniteteve i bëjnë nevojat e tyre për kujdes shëndetësor edhe më të mprehta. Në këto kushte, nisma dhe masa që do të rrisnin ndërgjegjësimin si dhe nivelin e informimit mbi kujdesin dhe shërbimet shëndetësore si dhe ato që do të lehtësonin dhe rrisnin aksesin ndaj tyre janë një domosdoshmëri.</p> <p>Problematika patjetër që do të ketë, por mund të përmendim që nga ana e Bashkisë Korçë është bërë një punë shumë e mirë tek të gjitha lagjet e qytetit edhe aty ku banojnë familje të komunitetit Rom dhe Egjiptian, në pjesën e infrastrukturës në çdo lagje të qytetit, gjithashtu ka filluar dhe projekti i termoizolimit të pallateve në çdo lagje të qytetit, ku përfituese janë dhe familje nga komuniteti rom dhe egjiptian.</p> <p>Nga një studim i kryer nga një organizatë për statistikë në Bashkinë Korçë janë reth</p>	
--	--	--	--	--

				<p>20.000 individë të cilët i përkasin komunitetit Egjiptian dhe reth 3.000 individë që i përkasin komunitetit Rom. Bashkia Korçë ka në funksionin e saj 3 (tre) Qendra Ditore Multifunkionale të cilat ofrojnë shërbim ditor për fëmijët e moshës 6-14 vjeç, ku pjesa dërmuese e fëmijëve që frekuentojnë këto qendra ditore janë pjesë e komunitetit Rom dhe Egjiptian, rreth 100 fëmijë, gjithashtu fëmijë të këtij komuniteti mbështeten dhe marrin shërbim tek Qendra për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara (5 fëmijë) dhe tek Qendra për Shërbimet Mbështetëse për Fëmijët dhe Familjen, ku marrin shërbim rreth 30 familje.</p> <p>Nga ana e Drejtorisë së Kujdesit Social trajtohen me ndihmë ekonomike rreth 350 familje nga komuniteti rom dhe egjiptian.</p> <p>Gjithashtu, Bashkia para çdo viti shkollor mbështet rreth 150 fëmijë me kite shkollore nga familjet e komunitetit rom dhe egjiptian, nga qyteti dhe nga njësitë administrative.</p> <p>Kampi Veror i cili organizohet çdo vit, në të cilin janë të përfshirë dhe fëmijë nga komuniteti rom dhe egjiptian.</p> <p>Mbështetje gjithashtu ky komunitet ka pasur çdo vit sipas kërkesave të tyre nga ana e Bashkisë me paketa ushqimore dhe higjienosanitare.</p>		
--	--	--	--	---	--	--

35.	04.12.2024	<p>Kërkesë për t'u pajisur me informacion: 1) Sa dhoma për intervistimin e të miturve në konflikt me ligjin janë ngritur në bashkinë tuaj dhe ku ndodhen ato?</p> <p>2) A ka pasur investime për përmirësimin e infrastrukturave që ofrojnë masat alternative për të mitur në bashkinë tuaj? Ku është investuar dhe sa?</p> <p>3) Sa të mitur në konflikt me ligjin kanë marrë masa alternative në bashkinë tuaj, për çdo vit, nga firmosja e marrëveshjes deri me 2024, duke përfshirë ata që janë nën 14 vjeç dhe ata që janë rikthyer në sistemin e drejtësisë penale?</p> <p>4) Sa qendra multifunktionale ka kjo bashki dhe ku ndodhen ato?</p> <p>5) Sa nga qendrat multifunktionale janë adaptuar pas firmosjes së marrëveshjes për të ofruar shërbime për të miturit në konflikt me ligjin, për rehabilitim, mbikëqyrje dhe edukim?</p> <p>6) Sa janë kostot e investuara nga bashkia për riadaptimin e</p>	16.12.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion 04.12.2024, sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Kujdesit Social Bashkia Korçë, ju bëjmë me dije se: Për intervistimin e të miturve, pranë komisarariatit të Policisë Korçë është një ambient i posaçëm për intervistimin e të miturve, e ndërtuar nga UNICEF. Ky ambient është i pajisur me sistemin video dhe audio. Njësia e Mbrojtjes së fëmijëve njihet me rastin e të miturve në konflikt me ligjin në momentin e parë kur fëmija merret në pyetje pranë Komisarariatit të Policisë/ Prokurorisë dhe më pas mban kontakt të vazhdueshëm me fëmijën, familjen, stafin e shkollës, shërbimin e provës, I EVP Kavajë, formimin profesional etj, kjo në varësi të rastit. Gjithashtu kjo njësi merr pjesë në proceset gjyqësore si përfaqësues proceduarial për të miturit në konflikt me ligjin.</p> <p>Kontakti me të miturit në konflikt me ligjin dhe familjarët e tyre konsiston në vlerësimin e nevojave dhe përgatitjen e një plani ndërhyrjeje për mbështetje. Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve realizon takime këshilluese dhe orientuese me qëllim shmangien nga recidivizmi. Gjithashtu, Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve ka organizuar takime të përbashkëta me Shërbimin e Provës dhe të miturit në konflikt me ligjin dhe ka</p>	E plotë	S'ka tarifë
-----	------------	---	------------	--	---------	-------------

		<p>këtyre qendrave multifunkionale nga firmosja e marrëveshjes, deri më 2024 për çdo vit?</p> <p>7) Çfarë lloj shërbimesh ofrohen në këto qendra për të miturit, përfshirë mbështetje psikosociale, arsimore dhe rehabilituese?</p> <p>8) Sa punonjës social të trajnuar për të ndjekur të miturit në konflikt me ligjin ka bashkia juaj në 2024?</p> <p>9) Sa të mitur janë dënuar me burgim në Bashkinë Korçë dhe sa janë përfshirë në shërbim prove ose masa alternative nga firmoja e marrëveshjes deri më 2024, për çdo vit?</p> <p>10) Sa të mitur nën 14 vjeç janë dënuar me burgim në Bashkinë Korçë dhe sa janë përfshirë në shërbim prove ose masa alternative?</p> <p>11) Sa të mitur në konflikt me ligjin nën 14 vjeç janë ndjekur nga punonjës socialë dhe sa janë të përfshirë në programet e mbikëqyrjes dhe rehabilitimit në bashkinë tuaj?</p>		<p>orientuar disa të mitur të marrin pjesë jo vetëm në kurset profesionale shtetërore, por edhe në kursin "Social Media" organizuar nga Bashkia në bashkëpunim me OJF, si një mundësi shumë e mirë punësimi në të ardhmen.</p> <p>Në vijim të trajtimit të rasteve të të miturve në konflikt me ligjin Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve përgatit për Shërbimin e Provës dhe Gjykatën, raport social-ekonomik.</p> <p>Në Bashkinë Korçë është ngritur Shërbimi Mbështetës për Fëmijët dhe Familjet ku pjesë e strukturës janë edhe dy psikologe. Në varësi të specifikave të rastit realizohen seanca këshillimi psikologjik për të miturit dhe seanca prindërimi të cilat kanë qëllimin orientimin e prindërve drejt prindërimit pozitiv me fëmijët e tyre.</p> <p>Gjithashtu, administratorët shoqërorë në 7 njësitë administrative, me urdhër kryetari kanë përgjegjësi edhe për mbrojtjen e fëmijëve.</p> <p>Përsa i përket trajnimeve në lidhje me ndjekjen e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin 2(dy) punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve pranë Drejtorisë së Kujdesit Social kanë ndjekur trajnime të cilat duhet të jenë më intesive dhe të vazhdueshme sepse rastet sa vjen dhe janë më dinamike.</p>		
--	--	--	--	---	--	--

		<p>12) Sa janë të miturit që kanë ndjekur programet e rehabilitimit pas përfundimit të dënimit dhe sa të mitur nga bashkia juaj janë recidivist?</p> <p>13) A keni akses në databazën kombëtare për ndjekjen e rasteve të të miturve në konflikt me ligjin?</p> <p>14) Si komunikon me databazën kombëtare për të miturit në konflikt me ligjin Bashkia Korçë?</p> <p>15) Sa raste të të miturve në konflikt me ligjin janë regjistruar në bashkinë tuaj në 5 vitet e fundit?</p> <p>16) A ka bashkia juaj një sistem të vetin për monitorimin e masave alternative për të miturit në konflikt me ligjin?</p> <p>17) Cilat projekte janë realizuar që nga firmosja e marrëveshjeve për drejtësinë alternative për të miturit? Sa kanë qenë kostot e investuara dhe a janë akoma funksionale?</p> <p>18) Sa fonde janë alokuar nga buxheti i bashkisë për zbatimin e këtyre projekteve?</p>		<p>Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve është gjithashtu në komunikim të vazhdueshëm me IEVP Kavajë për të miturit të cilët i përkasin Bashkisë Korçë, duke shkëmbyer informacion, por edhe duke hartuar plane pune se si këta të mitur të integrohen përsëri në shoqëri.</p> <p>Puna me fëmijët në konflikt me ligjin është sfiduese pasi bashkëpunimi me fëmijët dhe me familjarët është i vështirë. Numri i të miturve në konflikt me ligjin është si më poshtë vijon:</p> <p>Viti 2020 - 3 të mitur;</p> <p>Viti 2021 - 1;</p> <p>Viti 2023 - 6;</p> <p>Ndërsa për vitin 2024 deri tani numri i fëmijëve në konflikt me ligjin për vepra si vjedhje, drejtim automjeti pa leje drejtimi, konflikt, lëndë narkotike, etj është 10. Kryesisht fëmijët në konflikt me ligjin i përkasin gjinisë mashkullore. Në çdo projekt që Drejtoria e Kujdesit Social realizon të tilla si: kitet shkollore, Kampi Veror, Qendrat Ditore të Fëmijëve, përjashtim nga tarifa e kopshtit/çerdhes, përfshihen edhe fëmijë në konflikt me ligjin ose familjarë të tyre.</p>		
--	--	--	--	---	--	--

		<p>19) Sa të mitur kanë kryer masa alternative në bashkinë tuaj që prej vitit 2018 për çdo vit?</p> <p>20) Sa efektive është komunikimi mes njësive administrative të bashkisë dhe qendrave multifunktionale të adaptuara për drejtësinë alternative për të mitur? Sa raste nga firmosja e marrëveshjes nga bashkia juaj deri më sot janë transferuar nga njësia bashkiake drejtë qendrave multifunktionale të adaptuara për drejtësinë alternative për të miturit?</p>				
36.	06.12.2024	<p>Kërkesë për t'u pajisur me informacion:</p> <p>1. Sa dhoma për intervistimin e të miturve në konflikt me ligjin janë ngritur në bashkinë tuaj dhe ku ndodhen ato?</p> <p>2. A ka pasur investime për përmirësimin e infrastrukturave që ofrojnë masat alternative për të mitur në bashkinë tuaj? Ku është investuar dhe sa?</p> <p>3.Sa të mitur në konflikt me ligjin kanë marrë masa alternative në bashkinë tuaj, për çdo vit, nga firmosja e marrëveshjes me Ministrinë e Drejtësisë në 2018 deri me 2024,</p>	16.12.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion 06.12.2024, sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Kujdesit Social Bashkia Korçë, ju bëjmë me dije se:</p> <p>Për intervistimin e të miturve, pranë komisariatit të Policisë Korçë është një ambient i posaçëm për intervistimin e të miturve, e ndërtuar nga UNICEF. Ky ambjent është i pajisur me sistemin video dhe audio. Njësia e Mbrojtjes së fëmijëve njihet me rastin e të miturve në konflikt me ligjin në momentin e parë kur fëmija merret në pyetje pranë Komisarariatit të Policisë/ Prokurorisë dhe më pas mban kontakt të vazhdueshëm me fëmijën, familjen, stafin e shkollës, shërbimin e</p>	E plotë	S'ka tarifë

		<p>duke përfshirë ata që janë nën 14 vjeç dhe ata që janë rikthyer në sistemin e drejtësisë penale?</p> <p>4. Sa qendra multifunktionale ka kjo bashki dhe ku ndodhen ato?</p> <p>5. Sa nga qendrat multifunktionale janë adaptuar pas firmosjes së marrëveshjes për të ofruar shërbime për të miturit në konflikt me ligjin, për rehabilitim, mbikëqyrje dhe edukim?</p> <p>6. Sa janë kostot e investuara nga bashkia për riadaptimin e këtyre qendrave multifunktionale nga firmosja e marrëveshjes, deri më 2024 për çdo vit?</p> <p>7. Çfarë lloj shërbimesh ofrohen në këto qendra për të miturit, përfshirë mbështetje psikosociale, arsimore dhe rehabilituese?</p> <p>8. Sa punonjës social të trajnuar për të ndjekur të miturit në konflikt me ligjin ka bashkia juaj në 2024?</p> <p>9. Sa të mitur janë dënuar me burgim në Bashkinë Korçë dhe sa janë përfshirë në shërbim prove ose masa alternative nga firmoja e marrëveshjes deri më 2024, për çdo vit?</p>	<p>provës, I EVP Kavajë, formimin profesional etj, kjo në varësi të rastit. Gjithashtu kjo njësi merr pjesë në proceset gjyqësore si përfaqësues proceduarial për të miturit në konflikt me ligjin.</p> <p>Kontakti me të miturit në konflikt me ligjin dhe familjarët e tyre konsiston në vlerësimin e nevojave dhe përgatitjen e një plani ndërhyrjeje për mbështetje. Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve realizon takime këshilluese dhe orientuese me qëllim shmangien nga recidivizmi. Gjithashtu, Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve ka organizuar takime të përbashkëta me Shërbimin e Provës dhe të miturit në konflikt me ligjin dhe ka orientuar disa të mitur të marrin pjesë jo vetëm në kurset profesionale shtetërore, por edhe në kursin "Social Media" organizuar nga Bashkia në bashkëpunim me OJF, si një mundësi shumë e mirë punësimi në të ardhmen.</p> <p>Në vijim të trajtimit të rasteve të të miturve në konflikt me ligjin Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve përgatit për Shërbimin e Provës dhe Gjykatën, raport social-ekonomik.</p> <p>Në Bashkinë Korçë është ngritur Shërbimi Mbështetës për Fëmijët dhe Familjet ku pjesë e strukturës janë edhe dy psikologe. Në varësi të specifikave të rastit realizohen seanca këshillimi</p>		
--	--	---	---	--	--

		<p>10. Sa të mitur nën 14 vjeç janë dënuar me burgim në Bashkinë Korçë dhe sa janë përfshirë në shërbim prove ose masa alternative?</p> <p>11. Sa të mitur në konflikt me ligjin nën 14 vjeç janë ndjekur nga punonjës socialë dhe sa janë të përfshirë në programet e mbikëqyrjes dhe rehabilitimit në bashkinë tuaj?</p> <p>12. Sa janë të miturit që kanë ndjekur programet e rehabilitimit pas përfundimit të dënimit dhe sa të mitur nga bashkia juaj janë recidivist?</p> <p>13. A keni akses në databazën kombëtare për ndjekjen e rasteve të të miturve në konflikt me ligjin?</p> <p>14. Si komunikon me databazën kombëtare për të miturit në konflikt me ligjin bashkia Korçë?</p> <p>15. Sa raste të të miturve në konflikt me ligjin janë regjistruar në bashkinë tuaj në 5 vitet e fundit?</p> <p>16. A ka bashkia juaj një sistem të vetin për monitorimin e masave alternative për të miturit në konflikt me ligjin?</p>		<p>psikologjik për të miturit dhe seanca prindërimi të cilat kanë qëllimin orientimin e prindërve drejt prindërimit pozitiv me fëmijët e tyre.</p> <p>Gjithashtu, administratorët shoqërorë në 7 njësitë administrative, me urdhër kryetari kanë përgjegjësi edhe për mbrojtjen e fëmijëve.</p> <p>Përsa i përket trajnimeve në lidhje me ndjekjen e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin 2(dy) punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve pranë Drejtorisë së Kujdesit Social kanë ndjekur trajnime të cilat duhet të jenë më intensive dhe të vazhdueshme sepse rastet sa vjen dhe janë më dinamike.</p> <p>Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve është gjithashtu në komunikim të vazhdueshëm me IEVP Kavajë për të miturit të cilët i përkasin Bashkisë Korçë, duke shkëmbyer informacion, por edhe duke hartuar plane pune se si këta të mitur të integrohen përsëri në shoqëri.</p> <p>Puna me fëmijët në konflikt me ligjin është sfiduese pasi bashkëpunimi me fëmijët dhe me familjarët është i vështirë.</p> <p>Numri i të miturve në konflikt me ligjin është si më poshtë vijon:</p> <p>Viti 2020 - 3 të mitur; Viti 2021 - 1; Viti 2023 - 6;</p>		
--	--	--	--	---	--	--

		<p>17. Cilat projekte janë realizuar që nga firmosja e marrëveshjeve për drejtësinë alternative për të miturit? Sa kanë qenë kostot e investuara dhe a janë akoma funksionale?</p> <p>18. Sa fonde janë alokuar nga buxheti i bashkisë për zbatimin e këtyre projekteve?</p> <p>19. Sa të mitur kanë kryer masa alternative në bashkinë tuaj që prej vitit 2018 për çdo vit?</p> <p>20. Sa efektiv është komunikimi mes njësive administrative të bashkisë dhe qendrave multifunksionale të adaptuara për drejtësinë alternative për të mitur?</p>		<p>Ndërsa për vitin 2024 deri tani numri i fëmijëve në konflikt me ligjin për vepra si vjedhje, drejtim automjeti pa leje drejtimi, konflikt, lëndë narkotike, etj është 10. Kryesisht fëmijët në konflikt me ligjin i përkasin gjinisë mashkullore. Në çdo projekt që Drejtoria e Kujdesit Social realizon të tilla si: kitet shkollore, Kampi Veror, Qendrat Ditore të Fëmijëve, përjashtim nga tarifa e kopshtit/çerdhes, përfshihen edhe fëmijë në konflikt me ligjin ose familjarë të tyre.</p>																						
37.	17.12.2024	<p>Kërkesë për t'u pajisur me informacion :</p> <p>-Sa është shpenzuar për dekorin e zbulimeve në Korçë, për vitin 2024?</p> <p>-Burimi i financimit, me fondet e Bashkisë apo në partneritet?</p> <p>-Sa ka qenë numri i operatorëve konkurrues?</p>	24.12.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 17.12.2024, po ju vendosim në dispozicion të dhënat e marra nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Objekti i Shpenzimit</th> <th>Fondi i planifikuar</th> <th>Realizimi</th> <th>Nr i operatoreve konkurrues</th> <th>Subjekti fitues</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Shpenzime dekorative (ndricues dekorative)</td> <td>3,600,000</td> <td>3,408,000</td> <td>1</td> <td>Alb - Korrekt</td> </tr> <tr> <td>Blerje elemente dekorative te ndricuar</td> <td>4,200,000</td> <td>4,070,400</td> <td>2</td> <td>Selvije Abasllari</td> </tr> <tr> <td>Blerje instalacione dekorative metalike te ndricuar</td> <td>4,500,000</td> <td>3,600,000</td> <td>4</td> <td>Iceberg Communication</td> </tr> </tbody> </table>	Objekti i Shpenzimit	Fondi i planifikuar	Realizimi	Nr i operatoreve konkurrues	Subjekti fitues	Shpenzime dekorative (ndricues dekorative)	3,600,000	3,408,000	1	Alb - Korrekt	Blerje elemente dekorative te ndricuar	4,200,000	4,070,400	2	Selvije Abasllari	Blerje instalacione dekorative metalike te ndricuar	4,500,000	3,600,000	4	Iceberg Communication	E plotë	S'ka tarifë
Objekti i Shpenzimit	Fondi i planifikuar	Realizimi	Nr i operatoreve konkurrues	Subjekti fitues																						
Shpenzime dekorative (ndricues dekorative)	3,600,000	3,408,000	1	Alb - Korrekt																						
Blerje elemente dekorative te ndricuar	4,200,000	4,070,400	2	Selvije Abasllari																						
Blerje instalacione dekorative metalike te ndricuar	4,500,000	3,600,000	4	Iceberg Communication																						

38.	17.12.2024	<p>Kërkesë për t'u pajisur me informacioni mbi: 1. Na vendosni në dispozicion një kopje të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM).</p> <p>2. Na vendosni në dispozicion një kopje të projektit që po zbatohet në Përroin e Lubonjës.6</p>	27.12.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 17.12.2024, po ju vendosim në dispozicion të dhënat e marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Punimet e parashikuara në projekt kanë të bëjnë me pastrimin e mbeturinave të ndryshme të hedhura në shtratin e përroit, përforcimin e mureve anësore të rrugës për të shmangur gërryerjen apo shembjen e saj, mbrojtjen nga gërryeja e tokës nga krahu i banesave, etj. Të gjitha këto punime janë bërë në kuadrin e emergjencave civile, duke u bazuar dhe në kërkesat e banorëve, të cilët ndiheshin të rrezikuar nga prurjet dhe gërryeja e përroit. - Për këtë projekt nuk ka VNM. - Bashkëngjitur ju dërgojmë një kopje të projektit. 	E plotë	S'ka tarifë
39.	18.12.2024	<p>Kerkese per t'u pajisur me informacion mbi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Sa është numri i përgjithshëm i turistëve që kanë vizituar bashkinë tuaj gjatë tre viteve të fundit? 2. A keni statistika mbi përbërjen demografike të turistëve (kombëtarë dhe ndërkombëtarë)? 	27.12.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 18.12.2024, po ju vendosim në dispozicion informacionin nga Drejtoria e Turizimit, Projekteve të Zhvillimit dhe Migracionit e Diasporës Bashkia Korçë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Sa është numri i përgjithshëm i turistëve që kanë vizituar bashkinë tuaj gjatë tre viteve të fundit? 	E plotë	S'ka tarifë

		<p>3. Cilat janë periudhat me fluksin më të madh të turistëve gjatë vitit?</p> <p>4. Cilat janë destinacionet kryesore turistike brenda territorit të bashkisë suaj?</p> <p>5. A keni investuar në zhvillimin e destinacioneve të reja ose promovimin e atyre ekzistuese?</p> <p>6. Si bashkia mbështet ose bashkëpunon me bizneset lokale për të promovuar destinacionet turistike?</p> <p>7. Çfarë masash janë marrë për të përmirësuar infrastrukturën turistike (rrugë, qendra informacioni, objekte akomoduese)?</p> <p>8. A ka projekte aktuale ose të planifikuara për përmirësimin e qasjes së turistëve në destinacionet më të njohura?</p> <p>9. Cilat janë strategjitë tuaja për të promovuar bashkinë si një destinacion turistik?</p> <p>10 .A organizohen aktivitete të përvitshme për të tërhequr turistë (festa tradicionale, evente kulturore)?</p> <p>11. Si është ndikuar ekonomia lokale nga rritja e turizmit?</p>		<p>Bazuar në të dhënat e fundit të disponueshme:</p> <p>Në vitin 2021, Shqipëria ka pasur rritje të konsiderueshme të turistëve pas lehtësimeve të kufizimeve të pandemisë, dhe qyteti i Korçës ishte një nga destinacionet kryesore ku priti rreth 100,000 turistë, me rritje të ndjeshme pas pandemisë. Kjo përfshinte edhe një përqindje të madhe të turistëve të huaj gjatë aktiviteteve kryesore.</p> <p>Në vitin 2022, numri i vizitorëve në Korçë u rrit më tej, duke arritur mbi 150,000 turistë vetëm gjatë periudhave kulminante të verës dhe festave.</p> <p>Për vitin 2023, Korça ka pritur afërsisht 170,000 turistë në total, bazuar në raportet nga strukturat akomoduese dhe aktivitetet turistike të zhvilluara gjatë vitit, me një fokus të veçantë në promovimin e sezonit dimëror dhe aktiviteteve festive.</p> <p>Kjo sjell numrin total për tre vitet në 420,000 turistë të regjistruar që kanë vizituar Korçën.</p> <p>2. A keni statistika mbi përbërjen demografike të turistëve (kombëtarë dhe ndërkombëtarë)?</p> <p>Vizitorë të huaj: Turistët nga Kosova përbëjnë 42.6% të totalit të vizitorëve të huaj, të ndjekur nga Maqedonia e Veriut</p>		
--	--	---	--	--	--	--

		<p>12. A ka bashkia juaj një strategji të veçantë për markimin e destinacioneve turistike?</p> <p>13. Cilat janë prioritetet kryesore të bashkisë në lidhje me promovimin dhe diferencimin e destinacioneve turistike nga rajonet e tjera?</p> <p>14. Si promovon bashkia identitetin kulturor dhe historik të zonës përmes markimit të destinacioneve?</p> <p>15 .A është krijuar një markë e veçantë (logo, slogan) për të përfaqësuar destinacionet turistike të bashkisë?</p> <p>16. A bashkëpunon bashkia me agjenci turistike, platforma online, ose institucione të tjera për të promovuar destinacionet?</p> <p>17. Cilat kanale komunikimi (media sociale, reklama, ekspozita ndërkombëtare) përdorni për të markuar destinacionet?</p> <p>18. A keni tabelëzim dhe sinjalistikë të përshtatshme për të ndihmuar turistët të gjejnë dhe të informohen për destinacionet?</p> <p>19. A janë hartuar guida turistike, aplikacione ose materiale të tjera informuese për të përforcuar markimin?</p>		<p>(9%), Italia (8.1%), dhe Greqia (6.4%). Vizitorët nga Europa përbënin 91.8% të totalit të vizitave.</p> <p>Turistët kombëtarë dhe ndërkombëtarë: Përbërja gjinore ishte e ndarë në: 50.3% gra dhe 49.7% burra. Sa i përket grupmoshave, grupi 25–34 dhe 50-65 vjeç përfaqësonte përqindjen më të madhe të vizitorëve</p> <p>3. Cilat janë periudhat me fluksin më të madh të turistëve gjatë vitit?</p> <p>1. Dimri dhe fundviti (dhjetor – janar) Fluksi më i madh: Në fundvit, qyteti shndërrohet në një destinacion festiv falë ndriçimeve, dekorimeve dhe aktiviteteve kulturore, artistike dhe sportive dimërore. Kjo tërheq turistë vendas dhe ndërkombëtarë. Festa e ndriçimit të qytetit: Aktivitetet për hapjen e sezonit festiv zakonisht mbahen në fillim të dhjetorit dhe janë një pikë kulmore për vizitorët. Përvoja dimërore: Zonat përreth Korçës, si Dardha dhe Voskopoja, bëhen destinacione të preferuara për turizmin malor dhe sportet dimërore, duke krijuar një fluks të qëndrueshëm turistësh.</p> <p>2. Pranvera (prill – maj) Përfshirja e natyrës dhe kulturës: Ky është sezoni kur turistët shijojnë bukurinë e peizazheve pranverore në Korçë dhe</p>		
--	--	--	--	---	--	--

		<p>20. Si e mat bashkia efektivitetin e përpjekjeve të markimit të destinacioneve turistike?</p> <p>21 .A ka ndonjë plan për të përmirësuar markimin bazuar në reagimet e turistëve dhe banorëve lokalë?</p> <p>22. A ka destinacione të reja që po zhvillohen për t'u përfshirë në ofertën turistike të bashkisë?</p> <p>23. Si planifikoni të integroni këto destinacione të reja në identitetin ekzistues të bashkisë?</p>		<p>zonat përreth si: Vithkuqi dhe Liqeni i Prespës.</p> <p>Festivalet kulturore: Aktivitetet si "Spring Festival" “ Ballkan Fest” dhe aktivitete të tjera të kulturës ndihmojnë në rritjen e fluksit turistik gjatë kësaj periudhe.</p> <p>3. Vera (qershor – gusht)</p> <p>Festa e Birrës , Rock Festival, Lumina Electronic , Festivali i Serenatave dhe ngjarje të tjera: Këto aktivitete janë pika kulmore për turistët.</p> <p>Turizmi natyror: Vizitorët eksplorojnë zonat turistike si: Dardha, Voskopoja, Parku Kombëtar i Prespës e shumë destinacione të tjera nga rajoni, që ofrojnë aktivitete në natyrë dhe pushime relaksuese gjatë muajve të nxehtë.</p> <p>4. Vjeshta (shtator – nëntor)</p> <p>Fluksi sezonal i eventeve: Festa e Mollës dhe "Ditët e Mios" në nëntor janë momente kyçe për turizmin kulturor dhe gastronomik.</p> <p>Atraksione natyrore: Ngjyrat e vjeshtës në destinacionet si Voskopja , Dardha dhe zonat përreth bëhen një atraksion kryesor për turistët vendas dhe të huaj.</p> <p>4. Cilat janë destinacionet kryesore turistike brenda territorit të bashkisë suaj?</p>		
--	--	---	--	---	--	--

				<p>Disa nga destinacionet kryesore turistike brenda Bashkisë së Korçës përfshijnë një gamë të gjerë atraksionesh historike dhe natyrore:</p> <p>Pazari i Vjetër – Ky është një atraksion turistik i rëndësishëm që ka pasur një rol kyç në jetën e qytetit gjatë shekujve të 19-20. Pas rinovimit, Pazari i Vjetër është bërë një shembull i bukur i bashkimit të traditës me modernitetin, duke ofruar mundësi për të blerë suvenire dhe produkte tradicionale</p> <p>Xhamia e Iljaz bej Mirahorit – Ndërtesa më e vjetër në qytet, e ndërtuar në vitin 1496, është një simbol i trashëgimisë kulturore të Korçës. Vizitorët mund të mësojnë për historinë e saj interesante dhe të shohin arkitekturën e saj unike, duke përfshirë një kullë sahati të rindërtuar.</p> <p>Katedralja e Ngjalljes së Krishtit – Kjo është kisha më e madhe ortodokse në Shqipëri dhe një nga vendet më të rëndësishme për besimtarët dhe vizitorët. Ajo ka një histori interesante, pasi u rindërtua pas periudhës komuniste, dhe ka një arkitekturë madhështore që tërheq shumë turistë</p> <p>Muzeu i Artit Mesjetar – Ky muze është një nga atraksionet kryesore për artin dhe kulturën e Korçës, duke paraqitur vepra artistike nga shekujt 15-18 nga e gjithë Shqipëria. Kjo koleksion i artit është një</p>	
--	--	--	--	--	--

			<p>mundësi e shkëlqyer për të njohur trashëgiminë kulturore të qytetit me rreth 8000 ikona .</p> <p>Rinia Park: Një nga hapësirat më të bukura dhe të frekuentuara në qytet, që ofron relaks dhe shëtitje për banorët dhe turistët, veçanërisht gjatë stinës së pranverës dhe vjeshtës.</p> <p>Muzeu Arkeologjik i Korçës: I vendosur pranë Katedrales së Ngjalljes së Krishtit, ky muze prezanton zbulime dhe artefakte nga prehistoria deri në periudhën romake, duke ofruar një pasqyrë të trashëgimisë historike të rajonit.</p> <p>Shtëpia-Muze e Vangjush Mios: Një destinacion i dedikuar piktorit të famshëm shqiptar, që paraqet jetën dhe veprën e tij artistike në një ambient të restauruar dhe të ndërtuar me kujdes.</p> <p>Guri i Capit: Një pikë malore me pamje mbresëlënëse, ideale për turistët që kërkojnë aventura natyrore dhe eksplorim të peizazheve të egra.</p> <p>Mali i Moravës: Ofron shtigje për ecje dhe një pamje panoramike të qytetit të Korçës, duke tërhequr vizitorë të apasionuar pas turizmit natyror dhe sportiv.</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>Fermat dhe atraksionet e agroturizmit: Në zonat përreth qytetit, turistët mund të përjetojnë jetën e fshatit dhe të shijojnë produkte vendase si mollët e famshme të Korçës.</p> <p>Rrethinat natyrore – Për ata që janë të interesuar në natyrë, ka disa mundësi për ecje dhe aventurë në natyrë. Zona e Voskopojes, një fshat malor i njohur për arkitekturën e tij tradicionale dhe peizazhet spektakolare, është një destinacion shumë i vizituar. Po ashtu, fshatra të tjerë si Vithkuq dhe Dardha ofrojnë mundësi për ecje dhe eksplorim të natyrës aktivitetet dimërore dhe peizazhe të bukura</p> <p>5. A keni investuar në zhvillimin e destinacioneve të reja ose promovimin e atyre ekzistuese? Në lidhje me investimet në zhvillimin e destinacioneve të reja ose promovimin e atyre ekzistuese në Korçë, përfshin disa iniciativa kryesore.</p> <p>Qendra për Zhvillimin e Turizmit: Ka pasur investime për ndërtimin e një qendre moderne për zhvillimin e turizmit, e cila do të shërbejë si një qendër multifunktionale, duke përfshirë sallë konferencash dhe trajnime për operatorët turistikë. Ky projekt ka për qëllim të rrisë promovimin e destinacioneve të Korçës</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>dhe të ndihmojë në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm.</p> <p>Rivitalizimi i fshatrave turistike: Investimet janë bërë edhe në rinovimin e infrastrukturës dhe promovimin e fshatrave turistike si Dardha dhe Voskopoja. Këto fshatra janë destinacione të njohura për turizmin malor dhe sportet dimërore, dhe promovimi i aktiviteteve si ski dhe ecje në natyrë është një prioritet. Bashkia ka përfshirë edhe përmirësime të infrastrukturës dhe mundësi të tjera për vizitorët.</p> <p>Këto investime kanë si qëllim të përmirësojnë infrastrukturën dhe të shtojnë atraksionet turistike në rajon, duke përmirësuar përvojën e turistëve dhe rritur vizitat në destinacione ekzistuese dhe të reja.</p> <p>6. Si bashkia mbështet ose bashkëpunon me bizneset lokale për të promovuar destinacionet turistike? Bashkia e Korçës mbështet bizneset lokale për të promovuar destinacionet turistike nëpërmjet disa iniciativave dhe partneriteteve. Pjesë e kësaj mbështetjeje janë investimet për zhvillimin e infrastrukturës, krijimi i mundësive për promovimin e aktiviteteve dhe organizimi i ngjarjeve kulturore që tërheqin vizitorët. Një shembull është</p>	
--	--	--	--	--

			<p>përpjekja për zhvillimin e turizmit në rajonin e Korçës, ku janë realizuar projekte që përfshijnë rinovimin dhe zhvillimin e strukturave hotelerike, përmirësimin e mundësive për aktivitete kulturore dhe natyrore, si dhe organizimin e aktiviteteve të ndryshme që përfshijnë biznese lokale. Përveç kësaj, Bashkia ka investuar në krijimin e ambienteve që ofrojnë mundësi për workshop-e dhe aktivitete të tjera që mund të jenë të dobishme për bizneset lokale. Këto aktivitete janë menduar për të përmirësuar shërbimet dhe mundësitë që ofrohen për turistët, duke përfshirë dhe mundësi degustimi, shërbime të ndryshme në infrastrukturën hoteliere, dhe shërbime të tjera për promovimin e kulturës lokale.</p> <p>7. Çfarë masash janë marrë për të përmirësuar infrastrukturën turistike (rrugë, qendra informacioni, objekte akomoduese)?</p> <p>Për përmirësimin e infrastrukturës turistike në Bashkinë Korçë, janë ndërmarrë disa iniciativa dhe investime. Një nga projektet kryesore është transformimi i Qendrës së informacionit turistik të Korçës, e cila do të ofrojë shërbime për operatorët turistikë, hotele, restorante, si dhe mundësi për zhvillimin e aktiviteteve për studentët dhe biznese të</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>vogla. Ky investim synon rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe zhvillimin e turizmit në rajon, duke përfshirë edhe mundësinë e organizimit të workshop-eve dhe aktiviteteve të tjera.</p> <p>Përveç kësaj, ka pasur investime për përmirësimin e rrugëve dhe infrastrukturës rrugore, si për shembull: sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve që lidhin fshatrat turistike dhe qytetin. Këto përmirësime synojnë jo vetëm lehtësimin e qarkullimit, por edhe krijimin e kushteve më të mira për zhvillimin e turizmit dhe mbështetje për bizneset lokale</p> <p>8. A ka projekte aktuale ose të planifikuara për përmirësimin e qasjes së turistëve në destinacionet më të njohura? Për përmirësimin e qasjes së turistëve në destinacionet më të njohura të Korçës, janë planifikuar dhe po realizohen disa projekte kulturore , artistike dhe urbanistike. Një nga iniciativat kryesore është rehabilitimi dhe zhvillimi i infrastrukturës së shumë destinacioneve që përfshijnë histori, kulturë apo natyrë. Këto projekte përfshijnë rregullimin e shëtitoreve, parkut ujor dhe përmirësimin e qasjes nga rrugët. Gjithashtu, ka investime të tjera që synojnë të përmirësojnë aksesin dhe ofrimin e shërbimeve për turistët, duke përfshirë</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>mbështetje për biznese të ndryshme dhe strukturat akomoduese në rajon.</p> <p>9. Cilat janë strategjitë tuaja për të promovuar bashkinë si një destinacion turistik? Për promovimin e Korçës si një destinacion turistik, disa nga strategjitë kryesore përfshijnë: Përmirësimi i Infrastrukturës Turistike: Bashkia ka investuar në zhvillimin e infrastrukturës rrugore dhe turistike, për të mundësuar qasjen më të lehtë në destinacionet kryesore, siç janë Driloni, Tushemishti dhe Dardha. Ky zhvillim përfshin përmirësimin e shëtitoreve, krijimin e mundësive për aktivitete turistike dhe infrastruktura akomoduese.</p> <p>Promovimi i Turizmit Gjatë Të Katër Stinëve: Bashkia promovon Korçën si destinacion turistik tërheqës për çdo sezon. Disa nga aktivitetet dhe eventet e shumta kulturore , artistike, sportive dhe natyrore tërheqin turistë gjatë gjithë vitit.</p> <p>Mbështetje për Bizneset Lokale: Bashkia bashkëpunon me bizneset lokale për të promovuar turizmin, duke ofruar mundësi për përfshirje në aktivitete dhe mundësi trajnimi, si dhe përmes</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>mbështetjes për zhvillimin e agroturizmit.</p> <p>Marketing dhe Promovim: Strategjitë përfshijnë përdorimin e mediave sociale dhe platformave online për të promovuar ofertat turistike, duke rritur vizibilitetin e Korçës dhe të atraksioneve të saj natyrore, historike dhe kulturore. Përmes këtyre strategjive Korça po pozicionohet si një destinacion i qëndrueshëm dhe i pasur me mundësi për të tërhequr turistë nga të katër anët e botës.</p> <p>10. A organizohen aktivitete të përvitshme për të tërhequr turistë (festa tradicionale, evente kulturore)?</p> <p>Disa aktivitete të tjera të përvitshme që organizohen në Korçë për të tërhequr turistët:</p> <p>Festa e Birrës: Ky festival është një ngjarje e rëndësishme që mbledh prodhues të birrës dhe konsumatorë, duke ofruar mundësi për të shijuar birra lokale dhe ndërkombëtare, si dhe për të shijuar muzikë dhe aktivitete të tjera.</p> <p>Festivali Ndërkombëtar i Karnavaleve: Ky festival është një ngjarje e bukur që përfshin parada dhe aktivitete të ndryshme kulturore, me pjesëmarrës nga shumë shtete të ndryshme, duke sjellë një atmosferë festive në qytet.</p>	
--	--	--	--	--

